



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 410 Akti

Nr. 350 Vendimi
Tiranë, më 23.2.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Brunilda Bektoshi	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petrovic, në datën 19.02.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Mariana Shegani (Dedi)**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Mariana Shegani, e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Brunilda Bekteshi dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi. Për shkak të kandidimit të saj në Gjykatën e Lartë, iu dha përparësi rivlerësimit të saj.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 23.12.2019, të trupit gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Mariana Shegani, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionere Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues Firdes Shuli dhe Suela Zhegu deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, ndërsa Komisionerja Brunilda Bekteshi ka paraqitur, kërkesën për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit për këtë subjekt, për shkak të një procesi gjyqësor me palë ish-punëdhënësin, si dhe një kërkesë tjetër për përjashtimin e saj nga trupi gjykues, pasi gjatë hetimit ka rënë dijeni të disa fakteve/provave në dukje të ngjashme me një subjekt tjetër të rivlerësuar, nga trupi gjykues ku komisionerja ka qenë pjesë përbërëse e tij. Mbi kërkesat e komisioneres, trupat gjykuese të shortuara me vendimet datë 19.12.2019 dhe 3.12.2020, kanë vendosur mospranimin e kërkesave të komisioneres Brunilda Bekteshi, rrethana këto të cilat iu vënë në dijeni edhe subjektit të rivlerësimit përmes *e-mail*-it në datën 19.11.2020.

5. Në datën 9.1.2020, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në datën 23.1.2020, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

6. Në datën 1.2.2021, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit; (iii) mbi paraqitjen e pretendimeve brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 35 - 40 dhe 45 – 47, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në zbatim të vendimit të sipërcituar, subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit në datë 2.2.2021 dhe më 12.2.2021, subjekti dërgoi parashtresa/shpjegime në rrugë zyrtare së bashku me dokumentacionin shoqërues mbështetës.

8. Në datën 15.2.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Mariana Shegani, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike subjekti u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 19.2.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

9. Në datën 19.2.2021, u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Mariana Shegani, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petrovic. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani, iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues dhe shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

11. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani, kërkoi konfirmimin në detyrë.

12. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Mariana Shegani. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore dhe e rifilloi për shpalljen e vendimit, në datën 23.2.2021.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Znj. Mariana Shegani ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport¹ për dosjen nr. IND 01427, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur, për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas neneve 30 – 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

15. Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting*, në zbatim të nenit 31/1, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 23.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, fakt ky që konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003.

¹Me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2018.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, vlerësimet përfundimtare të saj, datë 18.02.2021, dërguar me e-mail, deklaratimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (dh) analizën financiare të bërë nga Njësia Ligjore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Nga shqyrtimi i provave të administruara nga Komisioni, për secilën nga pasuritë dhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultoi, si vijon:

1. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme, apartament me sip. 113m², rr. “M. Sh.”, Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 31.10.2002, nr. *** rep, të blerë me kredi. Vlera: 50.820 USD. Kontrata e kredisë bankare nr. ***, datë 25.7.2003. Pjesa takuese: 50%.

1.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Deklarim i rremë lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 113 m² në rrugën “M. Sh.”, Tiranë, pasi në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës 2003 dhe deklaratën e pasurisë *Vetting* është deklaruar blerë me kredi bankare (kredia bankare është marrë në datën 25.7.2003), ndërkohë kontrata e sipërmarrjes, datë 31.10.2002, citon se kësti i parë 15.000 USD është paguar ditën e lidhjes së kontratës, kësti i dytë 10.000 USD brenda muajit nëntor dhe kësti i tretë 25.820 USD brenda muajit mars, me kredi nga banka.*

Mungesë burimesh financiare të ligjshme për pagesën e kështit të parë dhe të dytë për apartamentin e mësipërm, pasi të ardhurat e realizuara nga subjekti dhe bashkëshorti, deri në vitin 2002, nuk justifikojnë vlerën e pasurive që ka disponuar subjekti deri në vitin 2002.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

1.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 me përshkrimin “apartament banimi me sip.113 m², Tiranë, në proces. Vlera: 52.000 USD. Burimi: kredi bankare për strehim.

1.3 Në deklaratën *Vetting*, për këtë pasuri, subjekti ka depozituar dokumentacionin përkatës².

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.4 Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK), Drejtoria Vendore Tirana³ Rurale 1, informon se në emër të shtetasve Mariana Spiro Shegani dhe I. S. Sh. figuron e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Sipas kartelës së pasurisë, pasuria apartament është me sip. 112.22 m². Kjo Drejtoria në përgjigjen e saj ka depozituar edhe kontratën e shitjes nr. ***, datë 31.1.2019, me palë shitëse shoqërinë “T.” sh.p.k. dhe palë blerëse Mariana dhe I. Shegani. Sipas kontratës rezultoi se çmimi i apartamentit do të jetë në shumën totale prej 50.820 USD, vlerë të cilën shitësi deklaroi se pala porositëse/blerëse e ka likuiduar totalisht me disa këste pagesash, të derdhura në arkën dhe llogarinë bankare të shoqërisë sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 10.10.2002, mandatarkëtimit nr. ***, datë 15.2.2003, mandatarkëtimit nr. ***, datë 3.10.2003, si dhe transfertës bankare të datës 7.12.2004, të transferuara në ish-Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot “Intesa Sanpaolo Bank”), shuma të përfituara totalisht nga shoqëria “T.” sh.p.k.

²Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2020.

1.5 UKT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020, ka informuar se shtetasi I. S. Sh. ka kontratën nr. ***, për objektin me adresë rr. “K. P.”, Tiranë, me statusin “aktiv” në kategorinë e konsumatorëve familjarë.

1.6 FSHU-ja me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020, informon se shtetasi I. Sh., referuar të dhënave sistemit të faturimit, identifikohet abonent me kontratën e furnizimit Nr. ***, në instancën Tiranë.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

1.7 Subjekti, në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting*, deklaroi si burim krijimi të kësaj pasurie kreditë në vlerën 52.000 USD.

Sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 31.10.2002, plani i pagesave ka qenë:

- kësti i parë prej 15.000 USD paguhet me nënshkrimin e kontratës;
- kësti i dytë prej 10.000 USD brenda muajit nëntor; dhe
- kësti i tretë prej 25.820 USD brenda muajit mars me kredi nga banka direkt në numrin e llogarisë së shoqërisë.

Ndërsa, në kontratën e shitjes, datë 31.1.2019, janë cituar pagesat e kryera për këtë pasuri, si vijon:

Tabela nr. 1

Dokumenti	Nr.	Datë	Shuma USD
Mandatarkëtim	***	10.10.2002	10,000
Mandatarkëtim	***	15.2.2003	7,000
Mandatarkëtim	***	3.10.2003	6,000
Transfertë bankare		7.12.2004	23,329
		Total	46,329

1.7.i Meqenëse shuma e likuiduar sipas dokumentacionit rezultonte më e ulët se sa vlera e pasurisë, Komisioni e ka pyetur⁴ subjektin se kur e ka paguar shumën prej 4.491 USD (diferenca mes vlerës së apartamentit 50.820 USD dhe shumës së paguar sipas dokumentacionit 46.329 USD).

1.7.ii Subjekti, në përgjigje, ka deklaruar se: *“Shuma prej 4.491 USD, nuk i është paguar shoqërisë, kjo vlerë është zbritur nga shuma totale e apartamentit prej 50.820 USD. Shuma prej 4.491 USD është vlera e pajisjeve hidrosanitare; pllakave të dyshemesë, dyer dritare, të apartamentit të porositur, të cilat janë blerë nga ana jonë dhe janë vendosur prej kompanisë ndërtuese”*.

1.7.iii Në mbështetje të deklaramit, subjekti ka depozituar edhe përgjigjen e shoqërisë “T.” sh.p.k., e cila konfirmon deklaramin e saj se shuma e mbetur i është likuiduar furnitorëve të kompanisë për materialet e kërkuara. Referuar kontratës së sipërmarrjes, rezulton se në nenin 8, germa “d”, është parashikuar lejimi i subjektit për të kryer ndryshime në apartamentin e saj.

1.7.iv Komisioni ka vlerësuar që shumën prej 4.491 USD ta përfshijë në analizën financiare si pagesë e kryer përgjatë vitit 2004, meqenëse është viti i fundit i likuidimeve për këtë pasuri dhe për vetë natyrën e materialeve të blera, mund të jenë blerë/paguar përpara hyrjes në apartamentin e ri/banesën e re.

1.7.v Nga korrespondenca e mbajtur nga Komisioni me “Intesa Sanpaolo Bank”⁵ (ish-Banka Amerikane), kjo e fundit informon mbi disbursimin e kredisë. Konstatohet se kredia e deklaruar nga subjekti në vitin 2003 në shumën 52.000 USD, është disbursuar në tri këste, si vijon:

⁴ Pyetësor nr. ***, datë 25.11.2020.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 19.5.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

Tabela nr. 2

Data	Vlera në USD
06/08/2003	17,500
07/12/2004	24,500
06/12/2006	10,000
Total	52,000

1.7.vi Komisioni e ka pyetur⁶ subjektin se si është kryer likuidimi i kësaj pasurie dhe në përgjigjen e saj ajo ka konfirmuar planin e pagesave të cituar në kontratën e shitjes, si dhe ka depozituar të njëjtat mandate. Subjekti ka rikonfirmuar se burimi i krijimit të kësaj pasurie është kredia bankare⁷. Gjithashtu, ka sqaruar se: *“Për dy pagesa në shumën 17.000 USD, sipas mandatarkëtimeve nr. ***, datë 10.10.2002 dhe nr. ***, datë 15.2.2003, për kontratën e sipërmarrjes, datë 31.10.2002, nr. *** rep., jam ndihmuar nga motra në shumën 2.000.000 lekë, shumë e cila është kthyer pas disbursimit të kredisë”*.

1.7.vii Për këtë deklaramin subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 9.9.2020, ku shtetasja N. S. D. (motra e subjektit të rivlerësimit) deklaron ndihmën financiare që i ka dhënë motrës së saj për blerjen e apartamentit. Znj. N. D. në deklaratën noteriale sqaron se në fillim të tetorit të vitit 2002 i ka dhënë motrës shumën 10.000 USD dhe në fillim të shkurtit të vitit 2003 i ka dhënë shumën 7.000 USD. Për këto shuma, subjekti ka deklaruar si burim:

- a. Shumën 2.000.000 lekë nga shitja e pasurisë “truall” bazuar në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 15.9.2003, në të cilën ka sqaruar se këtë shumë e kishte marrë si parapagim nga blerësi që në shtator të vitit 2002, por për arsye që lidheshin me probleme personale kontrata është formalizuar pas një viti.
- b. Kursime të tjera të krijuara më të ardhurat familjare (ku bën pjesë deklaruesja dhe prindërit) nga punësimi që prej vitit 1980 në Fabrikën e Bukës Tiranë, Fabrika e Miellit Tiranë (ku zotëron dhe një numër aksionesh), të ardhurat e prindërve nga pensionet e tyre, kontribute nga vëllai i subjektit, z. N. D., nga puna e tij në emigracion në Itali, si dhe interesat bankare të akumuluar, ndër vite, nga shumat e depozituara në Bankën e Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”) në emrin e saj dhe të babait S. D..

1.7.viii Subjekti ka depozituar⁸ edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 5.12.2020, të vëllait të saj, z. N. D., ku ky i fundit deklaron se i ka dhënë znj. N. D. shumën prej 1.900.000 lekësh, të cilën e dispononte nga të ardhurat e përfituara nga emigracioni.

1.7.ix Meqenëse subjekti ka deklaruar se huan e marrë nga motra e ka kthyer pas disbursimit të kredisë, Komisioni e ka pyetur⁹ se me kredinë e cilit vit e ka likuiduar motrën e saj (N. D.), pasi gjatë hetimit rezultonte se kredia ishte disbursuar dhe shpenzuar, si vijon:

- a) Kredia e datës 6.8.2003 është tërhequr dy herë në shumën totale 12.000 USD (6.000 USD në datën 2.10.2003, me të cilën është paguar mandatarkëtimi nr. *** dhe 6.000 USD në datën 19.11.2003).
- b) Kredia e datës 7.12.2004 është përdorur për të likuiduar këstin e apartamentit, ku në të njëjtën datë që është disbursuar, është paguar kësti në shumën 23.329 USD.
- c) Kredia e datës 6.12.2006 nuk rezulton të jetë tërhequr dhe me të rezulton të jenë paguar këstet e kredisë.

⁶Pyetësor nr. ***, datë 20.10.2020.

⁷Kontratë nr. ***, datë 25.7.2003.

⁸Pyetësor nr. ***, datë 25.11.2020.

⁹Pyetësor nr. ***, datë 25.11.2020.

1.7.x Në përgjigje subjekti ka sqaruar se: “*Kthimi i shumës 2.000.000 lekë është bërë në harkun kohor 2003 – 2008. Shuma 6000 USD është kthyer në datën 19.11.2003, diferenca është kthyer në shumën të ndryshme deri në vitin 2008*”.

1.xi Pas hetimit të kryer nga Komisioni, deklaratave noteriale (të tanishme) dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ për huan e marrë nga motra, Komisioni ka vlerësuar të mos e përfshijë në analizën financiare, këtë shumë si të ardhur. Kjo, për faktin se nuk rezultoi që kjo hua të jetë deklaruar nga subjekti as në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe as në deklaratën *Vetting*. Subjekti nuk e ka deklaruar as shlyerjen e saj përgjatë viteve 2003 – 2008. Nga ana tjetër konstatohet se dokumentacioni i depozituar për dhënien e ndihmës financiare, nuk provon ligjshmërinë e saj.

1.xii Komisioni kreu analizën financiare për secilin këst të paguar për të parë mundësinë e subjektit për të investuar në këtë pasuri.

1.9.xiii Meqenëse kësti i parë prej 10.000 USD është paguar në vitin 2002, vit ky që subjekti ka kryer edhe një investim tjetër në pasuri të paluajtshme (e trajtuar në pikën 3 të vendimit, pasuri e blerë në prill të vitit 2002), Komisioni kreu analizën financiare me të ardhurat dhe shpenzimet nga maj 2002 – tetor 2002, kur është paguar kësti i parë.

- Komisionit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, i rezultoi se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën **994.722 lekë** për të paguar këstin e parë të kësaj pasurie, si dhe të përballonte shpenzimet familjare.

1.9.xiv Kësti i dytë është paguar në datën 15.2.2003 në vlerën 7.000 USD. Duke qenë se subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare deri në vitin 2002, analiza është kryer vetëm me të ardhurat e përfituara nga data 1.1.2003, deri në momentin e pagesës së këstit, pasi nuk ka pasur mundësi për kursime nga vitet e mëparshme. Kursi i këmbimit është marrë kursit mesatar¹⁰ i muajit shkurt të vitit 2003 sipas Bankës së Shqipërisë.

- Komisionit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, i rezultoi se dukej se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 683.116 lekë të kryej pagesën e këstit të dytë, si dhe të përballojë shpenzimet familjare.

1.9.xv Kësti i tretë është paguar në datën 3.10.2003 në shumën 6.000 USD. Ky këst ka pasur si burim kredinë e rimbursuar në datën 6.8.2003. Nga kjo kredi (kësti i parë i saj) e rimbursuar në shumën 17.500 USD, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr në datën 2.10.2003, shumën 6.000 USD, me të cilën një ditë më vonë ka paguar këstin e tretë.

1.9. xvi Ndërsa kësti i katërt, i paguar në datën 7.12.2004, në shumën 23.329 USD, ka pasur si burim kredinë e rimbursuar në datën 7.12.2004, në shumën 24.500 USD. Kjo shumë është transferuar brenda të njëjtës date, me transfertë bankare, në llogarinë e shoqërisë.

1.9. xvii Në konkluzion të hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni konstatoi se: (i) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 1.677.838 lekë, për të paguar dy këstet e para të kësaj pasurie, të kryente investimet e tjera, si dhe të përballonte shpenzimet familjare; (ii) dukej se subjekti nuk kishte deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting*, deklaroi si burim krijimi kredinë e marrë në “Intesa Sanpaolo Bank” (ish-Banka Amerikane), në shumën 52.000 USD, ndërkohë, vetëm 29.329 USD janë paguar me kredi, ndërsa gjatë hetimit deklaroi huan në shumën 17.000 USD nga motra e saj; (iii) dukej se subjekti nuk kishte deklaruar huan e marrë nga motra e saj, shtetasja N. D., në deklaratën periodike të vitit 2003, si dhe shlyerjen e kësaj huaje përgjatë viteve 2003 – 2008. Kjo hua nuk rezultoi të jetë deklaruar as në deklaratën *Vetting*; (iv) mungonte dokumentacioni

¹⁰1 USD = 130.18 lekë.

justifikues për ligjshmërinë e burimit të huas, dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës¹¹ për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.10 Në lidhje me konstatimin e parë, subjekti ka parashtruar se *provon ekzistencën dhe mundësitë financiare për të bërë dhe përballuar shpenzimet/investimet, për rrjedhojë, shuma prej 1.677.838 lekësh është e ligjshme dhe duhet të merret në konsideratë nga Komisioni.*

Në lidhje me konstatimin e dytë dhe të tretë, subjekti ka parashtruar se *është bërë subjekt rivlerësimi në vitin 2003. Në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike", neni 21 i titulluar "Deklarimi" parashikohet se: "Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare behet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm". Si rrjedhojë, deklaratat periodike vjetore të vitit 2003 ka qenë deklaratat e parë që plotësohet sipas regjimit, modalitetit, formës dhe përmbajtjes së prezantuar në të. Sipas subjektit, mosdeklarimi i ndihmës financiare të marrë nga motra, është një pakujdesi e paqëllimtë në deklaratën periodike 2003, pasi edhe kredia u disbursua pjesërisht po në këtë vit, nga e cila është likuiduar një pjesë e kësaj ndihme financiare. Kam qartësuar kredinë, duke deklaruar burimin kryesor për blerjen e pasurisë/apartamentit, duke pasur në konsideratë që do të shlyeja edhe ndihmën financiare. Kjo bëhet më e besuar, për faktin se pjesa e dytë e ndihmës financiare së marrë nga motra në vitin 2003, është shlyer po në vitin 2003 me kredi, thënë edhe më sipër. Për shkak të plotësimin për herë të parë, mungesës së praktikës, paqartësive që natyrshëm buronin prej formës së deklaratës, mungesës së trajnimeve të duhura në këtë drejtim, kam harruar në mënyrë të paqëllimtë të deklaroj ndihmën financiare të marrë nga motra. Burimi kryesor i përballimit të çmimit të apartamentit ka qenë nga kredia dhe nëpërmjet saj do të likuidoja dhe pjesën më të madhe të huas. Kontrata e kredisë bankare nr. ***, datë 25.7.2003, ka për qëllim sa konfirmohet në nenin 1.1 të kontratës: "Banka bie dakot që t'i japë kredimarrësit një kredi në shumën 52.000 USD për blerjen e apartamentit të ri. Kredia do t'i disbursohet kredimarrësit me dy këste. Kësti i parë prej 17.500 USD do të disbursohet me bllokimin në hipotekë të apartamentit ekzistues që ndodhet në plazhin e Golemit. Kësti i dytë prej 34.500 USD do të disbursohet me bllokimin në hipotekë të apartamentit të ri ...".*

Në lidhje me mospërmendjen e ndihmës financiare edhe në deklaratën Vetting, ka pohuar se *kjo mangësi, është krijuar, për shkak të kohës së hershme të marrjes së kësaj ndihme financiare, ligjshmërisë së burimit të saj, likuidimit totalisht të saj në periudhën e përpilimit të deklaratës Vetting, afërsisë gjinore me motrën.*

*Marrëdhëniet e posaçme familjare (është shprehur ajo), më kanë bërë, jo të anashkaloj deklarinin e ndihmës financiare të marrë prej motrës sime, por e kam vlerësuar si një veprim/ndihmë financiare brenda familjes. Sipas subjektit, kthimi i ndihmës financiare /huas, është bërë në harkun kohor 2003 – 2008. Shuma 6.000 USD është kthyer në datën 19.11.2003, nëpërmjet kredisë me kontratën nr. ***, datë 25.7.2003, ndërsa diferenca është kthyer në shumën të ndryshme deri në vitin 2008. Duke i menduar të tilla kthime, si shpenzime, unë nuk mendoja se duhej të reflektoheshin në deklaratë.*

Në lidhje me konstatimin 4 se: *"Mungon dokumentacioni justifikues për ligjshmërinë e burimit të huas; depozitoni çdo dokumentacion për të provuar burimin e ligjshëm të huas së marrë nga motra juaj". Subjekti ka rikonfirmuar se burimi i krijimit të pasurisë apartament me sip. 113m², në rr. "M. Sh.", Tiranë, është kredia bankare, nr. ***, datë 25.7.2003, me palë kredidhënëse Banka*

¹¹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Amerikane e Shqipërisë, dhe për pagimin e dy kësteve të para sipas mandatarkëtimeve është ndihmuar nga motra në shumën 2.000.000 lekë, shumë e cila është kthyer pas disbursimit të kredisë.

Në mbështetje të këtij deklarimi (ka thënë subjekti) kam depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 9.9.2020, nëpërmjet së cilës motra e subjektit, znj. N. S. D., deklaroi shumën e dhënë për blerjen e apartamentit. Ajo deklaroi se në fillim të muajit tetor 2002 më ka dhënë shumën 10.000 USD dhe në fillim të muajit shkurt 2003 më ka dhënë shumën 7.000 USD. Për këto shuma ajo ka deklaruar si burim: (a) shumën 2.000.000 lekë nga shitja e pasurisë truall bazuar në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 15.09.2003, duke sqaruar se këtë shumë e kishte marrë si parapagim nga blerësi që në shtator 2002, por për arsye që lidheshin me probleme personale kontrata është formalizuar pas një viti; (b) kursime të tjera të krijuara më të ardhurat familjare, nga puna që kryente që prej vitit 1980 në Fabrikën e Bukës Tiranë, Fabrika e Miellit Tiranë (ku zotëron dhe një numër aksionesh), të ardhurat e prindërve nga pensionet e tyre, kontribute nga vëllai N. D. nga puna e tij në emigracion në Itali, si dhe interesat bankare të akumuluar ndër vite nga shumtë e depozituara në Bankën e Kursimeve (sot "Raiffeisen Bank") në emrin e saj dhe të babait S. D..

Po ashtu, subjekti ka parashtruar se ajo ka depozituar edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 5.12.2020, të vëllait, N. D., ku ky i fundit deklaroi se i ka dhënë N. D. shumën prej 1.900.000 lekësh, të cilën e dispononte nga të ardhurat e përfituara nga puna edhe nga emigracioni.

Subjekti ka referuar nenin D¹², pika 3, të Kushtetutës, vendimin nr. 13, datë 20.6.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe Kodin e Procedurës Civile, subjekti parashtron se duhen pranuar provat, kur provohen se ato janë marrë sipas formës ligjore. Për të provuar krijimin e burimit të ligjshëm të huas, subjekti ka depozituar: (i) deklaratën noteriale nr. ***, datë 9.9.2020; (ii) kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 15.9.2003, së një pasurie truall, nga e cila janë përfitur të ardhura në shumën 2.000.000 lekë. Lidhur me këtë dokument, subjekti ka shpjeguar se edhe pse kontrata është lidhur në vitin 2003 dhe pagesat janë bërë në 2002, motra e saj ka përfitur 2.000.000 lekë, të cilat i janë parapaguar në shtator të vitit 2002. Sipas subjektit, parapagimi është një veprim konkludent që dëshmon ekzistencën e marrëdhënies juridike paraprake, të krijuar ndërmjet motrës së saj dhe subjektit që ka fituar të drejtën e pronësisë mbi truallin, si dhe kryerja e pagesës së çmimit para nënshkrimit të kontratës së shitjes, provohet nga vetë kontrata e shitjes në të cilën është deklaruar se çmimi është paguar para nënshkrimit të kontratës.

Sipas subjektit, motra e saj, ka deklaruar burime të tjera kryesore, dhe të vërtetuara, të ardhurash të mbështetura në dokumentacion¹³ të plotë justifikues, kursime të krijuara me të ardhurat familjare, të ardhurat e prindërve nga pensionet e tyre. Kjo edhe për arsye se motra e saj, për shkak të statusit e pamartuar, kishte zgjedhur të jetonte me prindërit, ndihma e mësipërme e dhënë nga vëllai, ka ndihmuar në lehtësimin e shpenzimeve të jetesës së saj dhe të prindërve, si fond komplementar, përveç pagës mujore të saj dhe pensioneve të prindërve.

Për sa më sipër, subjekti ka paraqitur dokumentacion për të ardhurat e përfituara, për periudhën 1983 – 2002/shkurt 2003, nga anëtarët e familjes së saj, si: (i) të ardhurat e përfituara për këtë periudhë, nga puna (pensioni) i babait S. D., vlera prej 752.121 lekësh, si veteran vlera prej 84.319 lekësh, pra, gjithsej në vlerën 836.440 lekë; (ii) të ardhurat e përfituara nga puna (pensioni) nëna E. D., në vlerën përkatëse prej 593.808 lekësh, vërtetimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, nr. *** prot., datë 10.2.2021; (iii) të ardhurat e përfituara nga puna (pensioni) motra N. në vlerën përkatëse prej 852.217 lekësh sipas, fletë për llogaritje për periudhën e sigurimit, në të cilën rezultoi që motra ka qenë e punësuar që nga viti 1975, pra, 31 vjet e 9 muaj e punësuar, me të

¹² Refero parashtrimet e subjektit, datë 12.2.2021.

¹³ Kursime të krijuara me të ardhurat familjare, të ardhurat e prindërve nga pensionet e tyre; të ardhura nga puna që ka kryer që prej vitit 1980 në Fabrikën e Bukës Tiranë, Fabrika e Miellit Tiranë. 1.900.000 lekë të cilën e dispononte nga vëllai N. D., të ardhura të pasura gjendje (të ardhurat nga punësimi 1.6.1981 – 16.10.1992, 1998 -2003), mbështetur në deklaratën noteriale nr. ***, datë 5.12.2020.

*ardhurat përkatëse në vlera të konsiderueshme /paga për pozicion pune kategori të shtatë; (iv) të ardhurat e përfituara nga puna, vëllai N., janë që nga viti 1.6.1981– 16.10.1992, i cili ka shërbyer si oficer aktiv në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 9.2.2021, të këtij institucioni, nga i cili nuk kemi të dhëna në lidhje me vlerën e pagës gjatë kësaj periudhe, ndërsa për periudhën e mëvonshme, nga 1.1.1999 – shkurt 2003, vlera e të ardhurave nga paga për vëllainë, ka qenë në shumën përkatëse prej 1.656 792 lekësh, vërtetim i shoqërisë “A.”, datë 11.2.2021. Në total të ardhura nga pensioni/punësimi për të katër anëtarët e familjes janë në shumën 3.939.257 lekë (pa përfshirë të ardhurat nga punësimi në periudhat e sipërcituara, të pagës së motrës Natasha dhe vëllait, sa relatuar më sipër). Nga këto të ardhura, zbriten shpenzimet për jetesë sipas mënyrës së llogaritur nga Komisioni (për periudhën shtator 1992 –1997, vëllai ka qenë emigrant në Itali, siç rezulton nga pasaportat e paraqitura në përgjigje të pyetësorëve dhe, për pasojë, nuk duhet të llogaritet në shpenzimet për jetesë. Rezulton tepricë të ardhurash, dhe që sipas subjektit provohet bindshëm ligjshmëria e burimit të ndihmës financiare në dhënien e shumës 2.000.000 lekë/17.000 USD.*

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

1.11 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve të tij në prapësime, si dhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon:

1.12 Lidhur me vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramit të subjektit për burimin e ligjshëm të pasurisë apartament me sip.113 m², fituar sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 31.10.2002, trupi gjykues ka konstatuar se subjekti nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë dhe të plotë burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, në deklaratën periodike të vitit 2003, si dhe përgjatë viteve sipas pretendimit të saj për burimin “hua nga motra”.

1.13 Nga analizimi i deklaramive, trupi gjykues çmon se bazuar në faktet e dala dhe pranuar nga subjekti (vlerësuar si pakujdesi nga ana e saj), ka konstatuar se burimi i deklaruar përgjatë hetimit administrativ për pagesën e dy kësteve të para me hua nga motra, nuk gjendet në asnjë rrethanë referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, deklaramive periodike, *Vetting* apo deklaratës noteriale të motrës në kohë reale. Burimi i deklaruar, si në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore, është vetëm “kredi bankare”.

1.14 Pranimi nga ana e subjektit të rivlerësimit në shpjegimet e saj ndaj rezultateve të hetimit, të gjetjeve të Komisionit lidhur me pasaktësinë e evidentuar dhe pretendimi se deklarimi në deklaratën e pasurisë *Vetting*, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, ka qenë një pakujdesi e paqëllimtë, vlerësohet nga trupi gjykues si një pretendim i papranueshëm, për sa kohë procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë buron nga dispozitat kushtetuese dhe parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, që përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar me saktësi, vërtetësi dhe plotësisht pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tyre dhe të personave të lidhur me ta. Në këtë drejtim bazuar në pikën 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, jo pa qëllim ligjvënësi ka parashikuar që subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin dhe sipas pikës 3 të po këtij neni, si dhe ka detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Vërehet se ky koncept ligjor i subjektit është i qartë në parashtrimet e saj për pasurinë nr. 2, që do të arsyetohet më poshtë. Ky deklarim i subjekteve shërben si baza nga ku fillon procedura e verifikimit dhe kontrollit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit dhe, në këtë kontekst, trupi gjykues arrin në përfundimin se, për sa kohë, si pasojë e mosdeklarimit të plotë të burimit në deklaratën *Vetting*, si dhe për faktet e tjera që do të arsyetohen në vijim bëhet i pamundur identifikimi i dy elementeve thelbësorë në këtë çështje objekt vlerësimi: (a) shkaku i vërtetë që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit për të mos respektuar

kërkesat urdhëruese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë e tij; si dhe (b) arritja e besueshmërisë për vërtetësinë e tyre.

1.15 Nga ana tjetër, sikurse ndërlidhet me vijimësinë argumentuese në pikën 1.14, trupi gjykues duke vlerësuar dhe analizuar këtë çështje edhe në rrethanat e pretenduara nga subjekti, nuk i çmon bindëse shpjegimet e subjektit për sa kohë kjo hua e pretenduar si burim gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton të jetë deklaruar si hua e marrë në vitin 2003, shlyerja e saj po në këtë vit, detyrimi i mbetur, si dhe shlyerjet e pretenduara përgjatë viteve 2003 – 2008.

1.16 Trupi gjykues, për një gjykim objektiv të kësaj çështje, e vlerësoi këtë situatë edhe nën kontekstin e pretenduar nga subjekti, si një pakujdesi ku nuk ka pasur qëllim dhe motiv ta fshihte atë, dhe për të krijuar bindjen analizoi çdo provë të depozituar nga subjekti në funksion të deklarimit të saj.

1.17 Në këtë drejtim, subjekti ka depozituar vërtetim për të provuar se motra e saj ka përfutur të ardhura nga shitja e një pasurie truall sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.9.2003. Të ardhurat e pretenduara të përfuturara i referohen kontratës së nënshkruar në vitin 2003, ndërkohë pretendohet se kjo hua është dhënë nga motra respektivisht në fillim të tetorit të vitit 2002, është dhënë shuma 10.000 USD, dhe në fillim të shkurtit të vitit 2003 shuma 7.000 USD. Pretendimi i subjektit *se motra e saj i ka përfutur këto të ardhura në vitin 2002, provohet nga vetë kontrata e shitjes në të cilën është deklaruar se çmimi është paguar para nënshkrimit të kontratës*, vlerësohet relevante nga trupi gjykues, pasi nuk mbështetet në asnjë provë tjetër për të kuptuar dhe besuar për kohën (muajin/datën) kur ato janë përfutur realisht. Deklarata noteriale e motrës së subjektit, është bërë gjatë procesit të rivlerësimit dhe nuk është në pajtueshmëri me provat e tjera. Për sa i përket këtij akti, trupi gjykues ka në vëmendje qëndrimin që ka mbajtur në çështje të ngjashme edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit, ku, megjithëse akti nuk është i pavlefshëm në kuptim të legjislacionit për noterinë, merret me rezervë në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk është në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

1.18 Në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit vijues të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues ka konstatuar se:

- Për të ardhurat e babait, z. S. D., subjekti i rivlerësimit deklaroi se ky i fundit ka realizuar të ardhura nga pensioni në vlerën 836.440 lekë, por ky deklarim nuk është mbështetur në dokumentacion për të provuar këtë shumë, për rrjedhojë, trupi gjykues nuk i ka marrë në konsideratë në funksion të përllogaritjeve të kryera.

- Për të ardhurat e nënës, znj. E. D., subjekti deklaroi të ardhura nga pensioni në vlerën 593.808 lekë dhe ka depozituar vërtetim nr. *** prot., datë 10.2.2021, nga ISSh-ja, ku nga përllogaritjet e Komisionit rezultoi se të ardhurat nga pensioni për periudhën 1.1.1991 – shkurt 2003, janë në shumën 524.482 lekë.

- Për të ardhurat e motrës, znj. N. D., subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka realizuar të ardhura nga punësimi në shumën 852.217 lekë. Subjekti ka depozituar dokumentacion nga ISSh-ja, vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, si dhe përllogaritjet e kryera nga ky institucion (ISSh) për pensionin e përfutur, ku të dhënat për bazën e vlerësuar janë të indeksuara në vite për shkak të përllogaritjeve të masës së pensionit. Nga përllogaritjet e Komisionit, rezultoi se motra e subjektit ka realizuar të ardhura nga punësimi për periudhën 1.1.1991 – shkurt 2003, në shumën 868.171 lekë.

- Për të ardhurat e vëllait, z. N. D., subjekti ka depozituar vërtetim nr. *** prot., datë 9.2.2021, nga Ministria e Mbrojtjes, i cili pasqyron pagën referuese për vitet 1992 – 1995, në shumën 122.820 lekë. Vërtetim nr. *** prot., datë 11.2.2021, nga shoqëria “A.”, sipas së cilit për vitet 1999 – shkurt 2003, vëllai i subjektit ka realizuar të ardhura nga punësimi, në vlerën 1.659.248 lekë.

Në total, të ardhurat e realizuara nga familja, për vitet 1991 – shkurt 2003, janë në shumën 3.174.721 lekë.

1.19 Lidhur me shpenzimet e jetesës, ato janë përlllogaritur nga Njësia e Shërbimit Ligjor, 66% e të ardhurave për vitet 1991 -1999 dhe për vitet 2000 – 2003 sipas INSTAT¹⁴. Nuk janë përlllogaritur shpenzime jetese për vëllain e subjektit përgjatë viteve 1992 – 1997, pasi sikurse ka deklaruar subjekti ka qenë emigrant në shtetin italian.

1.20 Gjithashtu, gjatë seancës publike, subjekti qartësoi se trualli i shitur nga motra e saj me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 15.9.2003, në vlerën 2.000.000 lekë, ishte blerë më parë prej saj në vitin 1998, në vlerën 1.500.000 lekë.

1.21 Në këto kushte, duke i zbritur totalit të këtyre të ardhurave, shpenzimet e jetesës (në shumën 1.685.186 lekë), investimin në blerjen e truallit¹⁵ (në vlerën 1.500.000 lekë), si dhe depozitën bankare¹⁶ (në vlerën 591.101 lekë), rezulton se familja e origjinës së subjektit nuk mund të ketë kursyer shumën 17.000 USD ose 2.000.000 lekë, e cila deklarohet si e hua e marrë nga subjekti.

1.22 Në analizë të dokumentacionit të sipërcituar, trupi gjykues krijon bindjen se motra e subjektit N. D. dhe anëtarët e familjes së saj nuk kanë pasur mundësi t'i jepnin hua subjektit të rivlerësimit shumën e pretenduar prej 2.000.000 lekësh.

1.23 Me gjithë analizën e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, duke u bazuar në deklaratat noteriale dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti për huan e marrë nga motra e saj, trupi gjykues konstatoi se familja e origjinës së subjektit gjendej në pamundësi financiare për të investuar në huan e dhënë. Për këtë shkak, por edhe për faktin se: (i) nuk rezulton që kjo hua (sikurse u citua edhe më lart) të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe as në deklaratën *Vetting*; (ii) nuk janë deklaruar shlyerjet e saj përgjatë viteve 2003 – 2008, ashtu siç ka pretenduar dhe deklaruar gjatë hetimit; (iii) nuk ka specifikuar shumën që i ka kthyer motrës në secilin vit; (iv) nuk ka as një gjurmë të kohës për huan e marrë por as për shlyerjen e saj me anë të kredisë ashtu siç ka pretenduar subjekti; si dhe (v) deklarimi i kësaj huaje vetëm gjatë hetimit administrativ, është një burim i ri krijimi për pasurinë, trupi gjykues bindet që të mos e marrë në konsideratë këtë hua, si burim krijimi për këtë pasuri. Për sa më sipër, rezultati negativ financiar nuk ndryshon, pasi subjekti rezultoi të jetë në pamundësi në shumën 1.677.838 lekë, për të paguar dy këstet e para të kësaj pasurie.

1.24 Në konkluzion, për këtë çështje objekt vlerësimi, trupi gjykues, në konsideratë të fakteve të mos deklarimit në mënyrë të saktë e të plotë të burimit të kësaj pasurie dhe mos justifikimit të burimit të ligjshëm edhe të huas së pretenduar përgjatë procesit, krijoi bindjen se pasaktësitë në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklarimin e saj të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

2. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme, garazh me sip. 23.5m², në rr. “M. Sh.”, Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. * rep., datë 10.8.2004. Blerë me të ardhurat nga pagat. Vlera: 8.000 USD. Pjesa takuese: 50%.**

2.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: fshehje në deklaratat e interesave private, ndër vite, të dorëzuara në ILDKPKI të garazhit me sip. 23.5 m², me adresë rr. “M. Sh.”, Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 10.8.2004.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja.

¹⁵ Në vlerën 1.500.000 lekë

¹⁶ Gjatë hetimit subjekti ka depozituar dokumentacion nga “Raiffeisen Bank”, ku babai dhe motra e saj kanë pasur një depozitë dyemërore, e cila në 31 dhjetor 2002 ka qenë në vlerën 591.101 lekë.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

2.2 Komisionit i ka rezultuar se subjekti nuk e deklaroi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, kontratën e sipërmarrjes për blerjen e garazhit. Kjo pasuri deklarohet për herë të parë vetëm në deklaratën *Vetting*.

2.3 Për këtë pasuri subjekti ka depozituar¹⁷:

- Kontratë sipërmarrje, datë 10.8.2004, me palë sipërmarrëse shoqërinë tregtare "T." sh.p.k. dhe palë porositëse Mariana Dedi dhe I. Sh., për porositjen e një garazhi në godinën 11 kate, në S., Tiranë, me sip. 23.5m², në vlerën 8.000 USD (vërtetimi datë 10.8.2004 i dhomës noterisë Tiranë).

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.4 ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana¹⁸ Rurale 1, informon se në emër të shtetasve Mariana Spiro Shegani dhe I.S. Sh. figuron e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

2.4.1 Kjo drejtori në përgjigjen e saj ka depozituar kontratën e shitjes nr. ***, datë 31.1.2019, me palë shitëse shoqëria "T." sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasit Mariana dhe I. Shegani. Sipas kontratës çmimi i garazhit do të jetë në shumën totale prej 8.000 USD, vlerë të cilën shitësi deklaroi se pala porositëse/blerëse e ka likuiduar totalisht me dy këste pagesash, në arkën e shoqërisë, vërtetuar shlyerja me mandatarkëtimin nr. ***, datë 22.7.2004 dhe vërtetim pagesë e datës 31.1.2019, lëshuar nga shoqëria "T." sh.p.k., shuma të përfituara totalisht nga kjo shoqëri. Në kartelën e depozituar për këtë pasuri është administruar mandatarkëtimi nr. ***, datë 22.7.2004, për pagesën e shumës 5.000 USD, vërtetim pagesë, datë 11.10.2004, për pagesën e shumës 3.000 USD, si dhe vërtetim pagesë mbi likuidimin sipas mandatarkëtimeve datë 31.1.2019, ku vërtetohet se është likuiduar shuma 8.000 USD, për blerjen e garazhit me sip. 18 m².

2.5 Komisioni hetoi mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për likuidimin e kësaj pasurie. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim, të ardhurat nga pagat. Komisioni, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare deri në datën 22.7.2004, kur është paguar kësti i parë, si dhe analizën vjetore të vitit 2004, meqenëse kësti i dytë është paguar më 11.10.2004. Në përfundim, subjekti në të dy përlllogaritjet e kryera, rezultoi në balancë pozitive.

2.6 Në konkluzion për këtë pasuri, nisur nga faktet e dala, Komisioni konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për të investuar në blerjen e garazhit përgjatë vitit 2004, si dhe të përballojë të gjitha shpenzimet e tjera familjare, ndërkohë i kërkoi shpjegime subjektit për mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën periodike vjetore për vitin 2004.

2.7 Në funksion të kërkimit të Komisionit, subjekti ka parashtruar se mosdeklarimi i kësaj pasurie ka ardhur, si rrjedhojë, e një qasje të pakujdesshme në plotësimin e deklaratës periodike vjetore të vitit 2004 dhe se nuk ka pasur asnjë qëllim dhe motiv për të fshehur ekzistencën e kësaj pasurie.

2.8 Trupi gjyqësor, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, si dhe parashtrimeve të saj në prapësime, arsyeton si vijon:

Pasuria objekt vlerësimi është një pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting*, në përputhje me pikën 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ku disponohet se: "*Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin*". Për sa kohë është vërtetuar nga faktet e dala gjatë hetimit (arsyetuar në paragrafët 2.2-2.4), përfitimi i saj në mënyrë të ligjshme dhe se nga verifikimi i Komisionit mbi mundësitë financiare të subjektit për likuidimin e kësaj pasurie është vërtetuar burimi i ligjshëm i të ardhurave, mosdeklarimi i kësaj pasurie në deklaratën

¹⁷Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁸Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2020.

periodike çmohet si një pasaktësi e cila nuk mund të kualifikohet si një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

3. Në lidhje me pasurinë apartament me sip. 87.50 m², në K., Kavajë, sipas kontratës së porosisë, datë 17.3.2008. Kontratë shitje trualli nr. ***, datë 3.12.2015. Blerë me të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 45.5 m² në K. dhe nga pagat. Vlera: 35.000 euro dhe 335.360 lekë. Pjesa takuese: 50%.

3.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: (i) mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit me sip. 45.5 m², në Kavajë, blerë sipas kontratës, datë 2.4.2002, në shumën 3.600.000 lekë, pasi të ardhurat e realizuara nga subjekti dhe bashkëshorti deri në vitin 2002 nuk justifikojnë vlerën e pasurive që ka disponuar subjekti deri në vitin 2002; (ii) deklaram i rremë lidhur me vlerën e apartamentit të mësipërm, pasi në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës 2003 është deklaruar me vlerën 2.600.000 lekë, ndërkohë sipas kontratës rezulton vlera 3.600.000 lekë; (iii) në deklaratën e interesave private periodik vjetor të vitit 2008, subjekti ka deklaruar kontratë porosie për një apartament banimi në G., Kavajë, por nuk ka deklaruar vlerën e blerjes dhe burimin financiar që ka shërbyer për këtë blerje. Ka fshehur në deklaratën e interesave private të vitit 2008, detyrimin e mbetur për apartamentin e banimit ndaj shoqërisë, si dhe ka fshehur në deklaratën e interesave private të vitit 2016, shumën 15.000 euro, si pagesë e këstit të dytë; (iv) në deklaratën e interesave private periodik/vjetor të vitit 2015, subjekti ka fshehur kontratën e shitblerjes së truallit, nr. ***, datë 3.12.2015, në vlerën 335.360 lekë; (v) mbeten të paqarta arsyet e nënshkrimit të dy kontratave të porosisë për apartamentin në G., Kavajë dhe konkretisht kontrata e paraqitur nga subjekti që mban datën 17.3.2008, e cila citon “*porositur apartament banimi me sip. 93.5 m², ndodhur në katin e dytë të banimit...*”, si dhe kontrata e paraqitur nga ZVRPP-ja Kavajë, nr. ***, datë 9.1.2008, e cila citon “*apartamenti i porositur ndodhet në katin përdhe me sip. 87.5 m² + 6 m²...*”.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

3.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 me përshkrimin “*kontratë porosie për një apartament banimi në G., Kavajë*”.

3.3 Në deklaratën *Vetting*, për këtë pasuri, subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës¹⁹.

Hetimi i kryer nga Komisioni

3.4 ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kavajë,²⁰ informon se rezultojnë pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të shtetasve I. S. Sh., Mariana Spiro Shegani, duke specifikuar: pasuria me nr. ***, z k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 87.5 m² në emër të shtetasve I. dhe Mariana Shegani.

Ndërsa, nga pasuria me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, z. I. Sh. ka blerë sipërfaqen takuese të truallit prej 34.9 m².

3.5 FSHU-ja²¹ informon se z. I. S. Sh., referuar të dhënave sistemit të faturimit, identifikohet 1 (një) abonent me kontratën e furnizimit me Nr. ***, në instancën Kavajë.

3.6 Komisioni hetoi mbi secilin burim krijimi të kësaj pasurie sipas deklarimit në deklaratën *Vetting*:

- a) të ardhura nga shitja e apartamentit në K. me sip. 45.5 m²; dhe
- b) të ardhurat nga pagat.

¹⁹Aneks ***

në dosjen e ILDKPKI-së

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 5.6.2020.

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2020.

a) Lidhur me apartamentin në K. me sip.45.5 m², subjekti e deklaroi shitjen e tij në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 me përshkrimin “apartament me sip. 45.5m², K., Kavajë (kontrata e shitjes bashkangjitur). Vlera: 27.000 euro”.

a.i Lidhur me këtë pasuri, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kavajë²² ka informuar se, z. I. Sh. ka qenë pronar i pasurisë me nr. ***, z. k. ***, e llojit apartament me sip. 45.5 m² e përfituar me kontratën e shitjes nr. ***, datë 2.4.2002, midis shitësit A. Rr. dhe blerësit I. Sh.. Këtë pasuri z. I. Sh. ia ka shitur z. A. K., me kontratën e shitjes nr. ***, datë 23.4.2007, në vlerën 27.000 euro.

a.ii Gjatë hetimit rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka derdhur *cash* në llogarinë e tij bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, shumat:

- 20.000 euro, në datën 30.4.2007, me përshkrimin *cash* depozitë I. Sh.; dhe
- 7.000 euro, në datën 11.5.2007, me përshkrimin *cash* depozitë I. Sh./shitje shtëpie.

a.iii Për sa më sipër, lidhur me shitjen e apartamentit me sip. 45.5 m², trupi gjykues konstaton se:

- ✓ Subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi marrëdhënien kontraktore të shitjes së pasurisë, nga e cila është përfituar shuma prej 27.000 euro, e përdorur si burim i krijimit të pasurisë apartament me sip. 87.5 m².

b) Në lidhje me të ardhurat nga pagat, rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore dhe të ardhurat e përfituara nga pagat konfirmohen nga këto të fundit. Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor për vitet 2003 –2016, rezultoi se për të ardhurat e përdorura për investimin e kryer nuk kanë rezultuar problematika.

Lidhur me likuidimin e kësaj pasurie

3.7 Subjekti në deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratë porosie, datë 17.3.2008, me palë shoqërinë “Sh.” sh.p.k. dhe palë porositëse shtetasin I. Sh., për porositjen e një apartamenti banimi me sip. 93.5m², në katin e dytë të banimit, në Godinën nr. ***, në parcelën ***, në zonën turistike G., Kavajë, kundrejt çmimit 35.000 euro.

3.8 Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, u vërejt se ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kavajë²³ në praktikën e përcjellë ka të administruar kontratën e porosisë, datë 9.1.2008, me shoqërinë “SH.” sh.p.k., për blerjen e apartamentit nr. ***, kati ***, parcela ***.

3.9 Meqenëse rezultuan dy kontrata porosie, Komisioni i ka kërkuar sqarime subjektit lidhur me këto dy kontrata. Në përgjigje të saj, subjekti ka sqaruar se: “Me shoqërinë ‘Sh.’ sh.p.k., me NIPT ***, me administrator z. A. D. është nënshkruar vetëm kontrata e porosisë, datë 17.3.2008, kontratë e cila është dorëzuar dhe në deklaratën *Vetting*. Objekti i kontratës është: apartament banimi me sip. 93.5 m², ndodhur në katin e dytë të banimit të pallatit në godinën nr. ***, në parcelën ***, në zonën turistike G., Kavajë. Nuk kemi nënshkruar (as unë as bashkëshorti) asnjë kontratë porosie me shoqërinë ‘Sh.’ sh.p.k., përveç kontratës së sipërcituar, datë 17.3.2008. Pasuria që disponojmë është sipas kësaj kontrate. Sqaroj se kontrata e porosisë, datë 9.1.2008 (me porositës Mariana Shegani dhe I. Sh.), me shoqërinë ‘Sh.’ sh.p.k., për blerjen e një apartamenti nr. ***, kati ***, parcela ***, administruar nga ZVRPP-ja Kavajë, është në mungesë absolute vullneti të shprehur të porositësve, nënshkrimet kategorikisht nuk janë të porositësve Mariana dhe I. Shegani.

Menjëherë sapo u bëra me dije, nëpërmjet pyetësorit nr. 5, për ekzistencën e kontratës së porosisë, datë 9.1.2008 (me porositës Mariana Shegani dhe I. Sh.), me shoqërinë ‘Sh.’ sh.p.k., për apartamentin nr. ***, kati ***, parcela ***, G., Kavajë, i kam kërkuar administratorit të shoqërisë ‘Sh.’ sh.p.k., z. A. D., sqarime në lidhje me kontratën e datës 9.1.2008. Administratori i shoqërisë ‘Sh.’ sh.p.k., me e-mail-in e datës 7.1.2021, në përgjigje të kërkesës, i është drejtuar subjektit duke

²²Shkresë nr. *** prot., datë 5.6.2020.

²³Shkresë nr. *** prot., datë 5.6.2020.

i sqaruar se: 'Kontrata e datës 9.1.2008, nuk i përket apartamentit tuaj. Vendndodhja e apartamentit tuaj është në katin e dytë, përcaktuar saktë në kontratën midis palëve në datën 17.3.2008, midis meje në cilësinë e administratorit dhe z. I. Sh., në katin e dytë me sipërfaqe bruto 93.5 m². Apartamenti në katin përdhe në kontratën e datës 9.1.2008, i takon z. G. Ç.²⁴. Pasaktësia ka ndodhur nga një lapsus i yni i krijuar nga ana jonë gjatë plotësimit të dokumentacionit për aplikim në Agjencinë e Legalizimeve ... ”.

3.10 Sipas kontratës së porosisë, datë 17.3.2008, plani i pagesave ka qenë:

- kësti i parë në shumën 20.000 euro është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës.;
- kësti i dytë në shumën 15.000 euro do të paguhet pasi të jetë regjistruar gjithë ndërtimi sipas lejes së miratuar.

3.11 Gjatë hetimit rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga llogaria e tij në “Intesa Sanpaolo Bank” shumën 20.000 euro²⁵, datë 24.12.2007, me dy tërheqje nga 10.000 euro secila.

Kjo shumë ka shërbyer për likuidimin e kështit të parë, pasi subjekti deklaroi si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 45.5m², në Kryemëdhën.

3.12 Gjithashtu, rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka kryer pagesën për këstin e dytë nëpërmjet depozitimit në arkë, në “Tirana Bank”, në datën 29.7.2016, veprim ky me përshkrimin “*pagim kësti i dytë sipas kontratës të shumës 15.000 euro, për ‘Sh.’ sh.p.k.*”. Komisioni, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare në momentin e pagimit të kështit të dytë në datën 29.7.2016 dhe nuk konstatoi problematika.

3.13 Meqenëse blerja e këtij apartamenti është shoqëruar edhe me blerjen e truallit, Komisioni, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu edhe analizën financiare në momentin e blerjes së truallit në datën 6.12.2011. Si përfundim nuk konstatoi problematika në këto investime.

3.14 Për sa më sipër, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008, shumën e paguar për këtë apartament apo detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë “Sh.” sh.p.k, për të cilën iu kërkuan shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

3.15. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj për këtë konstatim, ka parashtruar: “*Mosdeklarimi i shumës së paguar për këtë apartament apo detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ‘Sh.’ sh.p.k., ka ardhur, si rrjedhojë e një pakujdesie të paqëllimshme në plotësimin e deklaratës periodike vjetore të vitit 2008, por, theksoj se në këtë deklaratë në kolonën ‘vlera në shifra dhe me fjalë’, të pjesës ‘Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit’ kam shënuar ‘kontratë sipërmarrje’ dhe kopjen e kontratës ia kam bashkëngjitur deklaratës, krahas dokumenteve të tjera, duke e quajtur të deklaruar në mënyrë të plotë këtë pasuri. Në deklaratën Vetting, në lidhje me këtë pasuri, kam paraqitur dokumentacion siç janë referuar edhe nga Komisioni, janë prova të cilat dëshmojnë në mënyrë bindëse vlerën e plotë të pasurisë dhe detyrimin që kishte mbetur për t’u paguar ndaj shoqërisë ‘Sh.’ sh.p.k., sipas pikës 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutë”.*

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

3.16 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga ana e subjektit në prapësime, vlerëson se mosdeklarimi i shumës së paguar për këtë apartament apo detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë “Sh.” sh.p.k. në deklaratën periodike të vitit 2008, ka vlerën e një pasaktësie. Fakti që në kontratën e porosisë është cituar shuma e kështit të parë të paguar me nënshkrimin e kontratës dhe se pagesa e kështit të dytë është kryer nëpërmjet transaksionit bankar krijojnë bindjen se plani i pagesave është

²⁴ Edhe Komisioni ka konstatuar se në praktikën e legalizimit përcjellë nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara, shkresë nr. *** prof., datë 8.6.2020, në listën e pasurisë pasqyrohet edhe ky shtetas.

²⁵Kjo shumë është krijuar me të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 45.5 m² në K., Kavajë.

respektuar, si dhe është paguar vlera totale e parashikuar në këtë kontratë. Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se kjo pasaktësi nuk ndikon në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit në këtë vendimmarrje.

Lidhur me investimin e bërë në pasurinë, apartament me sip. 45.5 m² në K., Kavajë

3.17 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 me përshkrimin “*apartament banimi pas vitit 1990, me sip. 45.5 m², në G., Kavajë. Vlera 2.600.000 lekë. Burimi: blerë me kursime nga paga dhe ndihma nga anëtarët e familjes*”.

3.18 Në kontratën e shitblerjes²⁶ nr. ***, datë 2.4.2002, vlera e apartamentit është në shumën 3.600.000 lekë.

3.19 Komisioni e ka pyetur²⁷ subjektin në lidhje me vlerën e kësaj pasurie, si dhe mbi burimin e krijimit, më konkretisht sa ka qenë kontributi i familjarëve në këtë investim.

3.20 Subjekti ka sqaruar se: “*Vlera prej 2.600.000 lekësh e shënuar është një lapsus. Vlera e pasurisë është ajo e përcaktuar në kontratën e shitblerjes, nr. ***, datë 2.4.2002*”.

3.21 Lidhur me kontributin e familjarëve, ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se: “*... ndihma nga anëtarët e familjes, janë pagesa të kryera nga subjekti gjerman D. G. F. T. Z. (***) , sot D.G. f. I. Z. (***)G., nënës së bashkëshortit. Pagesat janë kryer për ekspertin mr. R. F., një nga ekspertët e Projektit të Legjislacionit Ekonomik në Shqipëri, pranë Ministrisë së Financave, për marrëdhënien e qirasë, në periudhën 1994 – 1998, nga 500 USD/muaj, në total në vlerën 24.000 USD*”.

3.22 Në mbështetje të këtij deklarami, subjekti ka depozituar:

- Deklaratën noteriale nr. ***, datë 9.9.2020. Sipas kësaj deklarate, deklaruesja V. Sh. (nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit), ka deklaruar mbi pronësinë që zotëron, marrëdhënien e qirasë për vitet 1994 – 1998 dhe shumën e përfituar prej 2.000 USD/muaj nga kjo qiradhënie. Nga kjo shumë, ka deklaruar se 500 USD/muaj ia jepte djalit, z. I. Sh. (bashkëshorti i subjektit).

- Certifikatën për vërtetim pronësie.

- Kërkesën drejtuar subjektit gjerman *** (ish-***) për informacion në lidhje me marrëdhënien e qirasë.

- Përgjigjen e subjektit gjerman ***, ku bën me dije se *** nuk ruan dokumentacion financiar dhe logjistik, për më shumë se 10 vjet në arkivat e tij, për individët e kontraktuar si ekspert.

- Deklaratën e Dr. M. B., për marrëdhënien e qirasë, i cili deklaroi se ka punuar për *** dhe se një prej kolegëve të tij ka qenë edhe eksperti R. F., i cili ka qëndruar te familja Sh..

- Deklaratën noteriale nr. ***, datë 9.9.2020. Sipas kësaj deklarate, shtetasi I. Sh. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), rikonfirmon deklaratën e nënës së tij në lidhje me dhënien me qira të banesës, një eksperti të ekonomisë të organizatës gjermane *** gjatë viteve 1994 – 1998 dhe se ka përfituar vlerën 500 USD/muaj.

3.23 Komisioni, në analizë të deklaramëve të subjektit dhe provave të depozituara gjatë hetimit, vlerësoi që këto të ardhura të mos i konsideronte²⁸, pasi nuk u provua me dokumentacion marrëdhënie e qirasë, vlera e përfituar nga qiraja mujore dhe as nuk rezultoi që të ishin paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Dokumentacioni i depozituar gjatë fazës së hetimit administrativ, duket se mbeti në nivel deklarativ dhe i pambështetur në prova.

²⁶ Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe përgjigje ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë, nr. *** prot., datë 5.6.2020.

²⁷ Pyetësor nr. ***, datë 20.10.2020.

²⁸ Duke lënë të hapur administrimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e çdo prove të sjellë në prapësime nga subjekti.

3.24 Komisioni, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare me të ardhurat e përfituara nga viti 1992 deri në momentin e investimit. Gjatë hetimit rezultoi se subjekti ka investuar në vitin 1996, për blerjen e një automjeti tip “****”, në shumën 500.000 lekë, e cila u përfshi në analizën e kryer.

3.25 Në konkluzion të hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni konstatoi se: (i) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 1.354.372 lekë, të investonte, si dhe të përballonte të gjitha shpenzimet e tjera familjare; (ii) mungonte dokumentacioni justifikues për përfitimin e të ardhurave nga qiraja dhënë nga nëna e bashkëshortit, si dhe i shlyerjes së detyrimeve tatimore për këto të ardhura përgjatë viteve 1994 – 1998, duke i kaluar barrën e provës²⁹ për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

3.26 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në prapësimet e saj, ka parashtruar se: *...në lidhje me investimin e bërë në pasurinë, apartament me sip. 45.5 m², në Kavajë, K., nga ana e Komisionit, mbi konstatimet e tij, në funksion të barrës së provës subjekti ka parashtruar se ashtu siç është deklaruar në DPV-në e vitit 2003, apartamenti i banimit me sip. 45.5 m², në Kavajë, K. është blerë me kursime nga paga dhe me ndihma nga anëtarët e familjes. Ndër të tjera, siç edhe Komisioni e ka paraqitur në material kam dhënë shpjegime plotësuese se: “...ndihma nga anëtarët e familjes, janë pagesa të kryera nga Subjekti gjerman D. G. F. T. Z. (***), sot D. G. F. I. Z. (***G., nënës së bashkëshortit. Pagesat janë kryer për ekspertin Mr. R. F., një nga ekspertët e Projektit të Legjislacionit Ekonomik në Shqipëri, pranë Ministrisë së Financave, për marrëdhënien e qirasë, në periudhën 1994–1998, nga 500 USD/nuaj, në total në vlerën 24.000 USD”. Për të vërtetuar krijimin e marrëdhënies së qirasë subjekti ka depozituar edhe njëherë të gjithë dokumentacionin e cituar më sipër në pikën 3.22.*

*Mbi moskonsiderimin e këtyre të ardhurave në rezultatet e hetimit, subjekti ka parashtruar se nëna e bashkëshortit saj, znj. V. Sh., e ka dhënë pronën e saj me qira në vitet 1994 – 1998, për llogari të subjekti gjerman D. G. F. T. Z. (GTZ), sot D. G. F. I. Z. (GIZ)G.. Deklarimi i burimit të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 45.5 m², Kavajë, që në vitin 2003: “Ndhma nga anëtarë të familjes”, në DVP hedh dritë mbi ligjshmërinë e pasurisë. Vlera e tregut në lidhje me qiranë mujore të pronës së dhënë me qira nga nëna e bashkëshortit në periudhën 1994 – 1998, konfirmohet dhe nga vlerësimi i kryer nga eksperti³⁰ vlerësues i pasurive të paluajtshme ing. A. Sh.. Vlera e tregut e qirasë mujore për pasurinë nr. ***, z. k. ***, në periudhën 1994 – 1999 është 2452 USD/muaj ...”. Në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës, ndonëse nuk jam subjekt i detyrimit të tatimit në burim mbi të ardhurat, sipas “Deklarata e tatimit të mbajtur në Burim mbi të ardhurat” nxjerrë nga sistemi tatimor në datën 10.2.2021, sipas procedurave të ligjit tatimor, kam paguar tatimin në burim, në ‘Credins Bank’, me urdhërpagesë në shumën përkatëse prej 401.785 lekësh, për shumën e të ardhurave nga qiratë e përfituara prej 24.000 USD / 2.608.577 lekë (me kursin e këmbimit të kohës), të cituar më sipër. Subjekti ka depozituar pagesën e kryer, deklaratën tatimore, llogaritjen e tatimit në burim të paguar. Kjo pagesë kryhet aktualisht në datën 11.2.2021, për shkak të mungesës së dokumentacionit si pasojë e kohës tejet të largët, 27 vjet më parë që daton marrëdhënien e qirasë. Mungesa e dokumentacionit kontabël në lidhje me marrëdhënien e qirasë rezulton nga përgjigjja e fondacionit gjerman ***, ... subjekti ka shpjeguar se duke mos pasur asnjë lloj qëllimi dhe motivi për të fshehur këto të ardhura, ta kryej vetë pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja e lartpërmendur, sipas pjesës që ka përfutuar bashkëshorti im në shumën 401.785 lekë. Pavarësisht mangësisë së evidentuar të dokumentacionit për marrëdhënien e qirasë*

²⁹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

³⁰ Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit.

sa më sipër, shpjegoj bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave për investimin në pasurinë apartament me sipërfaqe 45.5 m² të ndodhur në K., Kavajë.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

3.27 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, si dhe parashtrimeve të saj në prapësime, për burimin e krijimit të kësaj pasurie, arsyeton si vijon:

3.27.i Si fillesë, trupi gjykues konstatoi se subjekti e kishte deklaruar ndihmën e dhënë nga familjarët si burim krijimi të pasurisë apartament me sip. 45.5 m² që në deklaratën periodike të vitit 2003. Po ashtu, gjatë hetimit administrativ subjekti saktësoi burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, që vinin nga dhënia me qira e pasurisë në pronësi të nënës së bashkëshortit. Por, dokumentacioni i depozituar gjatë fazës së hetimit administrativ në mbështetje të deklaratimit, duket se mbeti në nivel deklarativ dhe i pambështetur, pasi nuk u provua marrëdhënia e qirasë, vlera e përfituar nga qiraja mujore dhe as nuk rezultoi që të ishin paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

3.27.ii Në prapësime subjekti depozitoi raport vlerësimi për pasurinë e paluajtshme, të punuar nga ing. A. Sh., mbi vlerën e pronës e cila ishte dhënë me qira. Vërehet se vlerësuesi ka përdorur si bazë vlerësimi Metodën e Krahasimit të Drejtpërdrejtë mbështetur në Standardin Europian EVS 2020. Në këtë raport vlera e qirasë për ambiente shërbimi paraqitet 10 USD/m²/muaj dhe për truall 1 USD/m²/muaj. Në përfundim, vlerësuesi arrin në konkluzionin se vlera e tregut e qirasë mujore për periudhën 1.7.1994 – 31.12.1999, ka qenë 2.452 USD/muaj³¹.

3.27.iii Trupi gjykues, pas hulumtimit³² për metodën e vlerësimit të përdorur nga vlerësuesi, konstatoi se ka disa metoda që përdoren për vlerësimin e pronave. Metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë (që është përdorur edhe nga vlerësuesi) përdoret për vlerësimin e të gjitha pronave që kanë treg, treg shitjeje ose treg dhënieje me qira. Kjo metodë funksionon në bazë të krahasueshmërisë dhe përcakton kryerjen e vlerësimit nëpërmjet krahasimit direkt të pronës objekt vlerësimi me prona të tjera të ngjashme të cilat janë shitur ose dhënë me qira, pra, kanë qenë objekt i tregut në të shkuarën. Duke përdorur evidencat e këtyre transaksioneve përcaktohet vlera e pronës, objekt vlerësimi. Por, trupi gjykues nuk konstaton në raport asnjë krahasim të pronës objekt vlerësimi me prona të ngjashme për të arritur në konkluzionin e vlerës së qirasë mujore prej 2.452 USD/muaj. Gjithashtu, çmimi i vendosur prej vlerësuesit është për të gjithë sipërfaqen e ndërtesës, ndërkohë që subjekti dhe familja e saj kanë banuar³³ po në këtë ndërtesë, ku kanë pasur në dispozicion ambientin prej një dhomë e një kuzhinë. Pra, paqartësitë e krijuara nga ky akt, të cilat duket se nuk janë të nivelit teknik, pasi nuk do të mund të trajtoheshin nga trupi gjykues, duket se nuk ndikojnë në dobi të pretendimit të subjektit, minimalisht për të konsideruar raportin si një provë indirekte.

3.28 Për çmimin e qirasë të pretenduar prej 2.000 USD/muaj, subjekti ka depozituar pagesën e tatimit në burim në datën 10.2.2021, në vlerën 401.785 lekë, detyrim ky që i korrespondon shumës së pretenduar si të përfituar prej saj (24.000 USD)³⁴ gjatë viteve 1994–1998.

3.29 Trupi gjykues konstaton se detyrimi për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara është i nënës së bashkëshortit për shkak të deklaratimit dhe pretendimit të subjektit se marrëdhënia e qirasë ka qenë ndërtuar në këtë mënyrë. Megjithatë ky detyrim nuk është përmbushur prej saj dhe

³¹ Pasuria është truall + ndërtesë. Sipërfaqja e truallit është 324 m² nga të cilat 112 m² ndërtesë. Ndërtesa është dykatëshe me nga 112 m² secili kat, me sipërfaqe totale 224 m². Për çmimet e referuara rezulton se: 224 m²x10 USD/m² = 2.240 usd/muaj dhe 212 m² x 1 usd/ m² = 212 usd/muaj

Në total 2.240 usd/muaj + 212 usd/muaj = 2.452 usd/muaj.

³² <https://www.tegova.org/>

³³ Deklaruar në pyetësorin nr. *** datë 25.11.2020.

³⁴ 500 USD/muaj për 4 vite.

as nga subjekti përpara dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Shuma e paguar nga subjekti nuk pasqyron detyrimin real sepse është pasqyruar sikur kjo e ardhur është përfituar në janar të vitit 2021, ndërkohë duhet të ishte për vitet 1994 –1998. Nëse subjekti do të kishte bërë pasqyrim real të viteve të përfitimit atëherë duhet të kishte paguar edhe gjoba, interesa për deklarim dhe pagesë të vonuar. Edhe jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit cilëson se pagesat e tatimeve të kryera pas deklaratës *Vetting*³⁵, nuk merren në konsideratë nga trupi gjykues, pasi, të krijojnë bindjen se janë veprime të subjektit të rivlerësimit për të sistemuar situatën financiare. Legjitimiteti i një shume të pretenduar si e përfituar në një periudhë relativisht të largët, vetëm si rezultat i tatimit të paguar, apo edhe i deklarimit të ndihmës në kohë reale por pa e përcaktuar shumën konkrete, nuk konkurren në raport me mungesën: (i) e një marrëdhënie kontraktore ku të mund të vërehej shuma e qirasë së përfituar; (ii) e një pasqyrimi në një regjistër noterial se ka pasur një kontratë për më tepër kur pretendohet se ka qenë midis dy individëve, ku njëri prej tyre ka ushtruar detyrën e ekspertit të huaj pranë një institucioni, duke u presupozuar se duhet të ishte ligjërues një marrëdhënie qiraje me detyrime të ndërsjella; apo edhe me (iii) raportin e vlerësimit të pasurisë, defektet e të cilit u trajtuan më sipër.

✓ Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se të ardhurat nga qiraja nuk mund të merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare, pasi subjekti i rivlerësimit nuk përmbushi detyrimin ligjor në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të provonte me dokumentacion përfitimin e të ardhurave nga qiraja nga prindërit (nëna) e bashkëshortit. Në këto kushte subjekti rezulton në pamundësi financiare në shumën 1.354.372 lekë për të investuar në këtë pasuri.

4. Automjet “**”, kontratë shitblerje fat. nr. ***, datë 5.5.2011.** Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor me targa ***, datë 5.5.2011. Blerë me të ardhurat nga shitja e makinës tip “****”, me targa *** dhe tip “****” me targa *** dhe të ardhurat nga pagat. Vlera: 31.500 euro. Pjesa takuese: 50%.

4.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga DPSHTRr-ja.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

4.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, me përshkrimin “***, kontratë shitblerje fat. nr. ***, datë 5.5.2011. Vlera: 31.500 euro”.

4.3 Subjekti, për këtë pasuri në deklaratën *Vetting*, ka depozituar dokumentacionin përkatës³⁶:

Hetimi i kryer nga Komisioni

4.4 DPSHTRr-ja me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2020, informon se shtetasi I. S. Sh. ka patur në pronësi automjetin me targa ***.

4.4.i Nga dokumentacioni i depozituar nga kjo drejtori, rezulton se ky automjet është blerë me faturën tatimore nr. ***, datë 5.5.2011, nga shoqëria “****”, në vlerën 31.500 euro, ekuivalente në 4.482.450 lekë dhe shitur më pas me kontratën e shitjes nr. ***, datë 19.5.2017, me palë shitëse I. Sh. dhe palë shitëse “****”, në vlerën 8.000 euro. Shitja e automjetit është kryer pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

4.5 Komisioni i ka kërkuar³⁷ subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues për likuidimin e kësaj pasurie të luajtshme dhe në përgjigjen e saj ka deklaruar se pagesat janë kryer sipas planit të mëposhtëm:

Tabela nr. 3

³⁵Referuar edhe vendimit nr. 5, datë 13.2.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

³⁶Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁷Pyetësor nr. *** datë 20.10.2020.

Datë	Shuma në euro
27.10.2011	18,700
30.12.2011	5,000
17.1.2012	7,800
Total	31,500

4.6 Për të mbështetur këtë deklaram, subjekti ka depozituar:

- Vërtetim, datë 21.10.2020, të shoqërisë “****” s.h.p.k;
- faturë tatimore shitje me nr. serie ***, nr. fature ***, datë 5.5.2011, në vlerën 31.500; euro (konvertuar në 4.482.450 lekë);
- ditar klienti nga shoqëria “****” sh.p.k.; si dhe
- ekstraktin e “Raiffeisen Bank”, për shoqërinë “****” sh.p.k., ku identifikohet emri i bashkëshortit të subjektit dhe pagesat e kryera për vitin 2011 dhe 2012.

4.7 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

4.7.i Subjekti, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklaroi se kanë shërbyer si burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****” me targa ***, automjetit tip “****” me targa ***, si dhe të ardhurat nga pagat.

4.7.ii Gjatë hetimit rezultoi se automjeti tip “****”, me targa *** është shitur me kontratën e shitjes nr. ***, datë 4.4.2005, në vlerën 120.000 lekë.

4.7.iii Ndërsa rezultoi se automjeti tip “****”, me targa *** është shitur me kontratën e shitjes nr. ***, datë 31.3.2007, në vlerën 200.000 lekë.

4.7.iv Subjekti, në deklaratën periodike të vitit 2005 dhe 2007, nuk rezultoi të ketë deklaruar gjendje *cash*, kursime apo mbartje të gjendjes *cash* deri në vitin 2011 kur është investuar për këtë pasuri.

4.7.v Në këto kushte, Komisioni, të ardhurat e përfituara nga shitja e këtyre automjeteve i ka përfshirë vetëm në vitet përkatëse kur janë përfitur. Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare vetëm me të ardhurat e përfituara gjatë vitit 2011 për dy këstet e para më 27.10.2011³⁸ dhe më 30.12.2011.

- ✓ Trupit gjykues, pas kryerjes së analizës financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor, i rezultoi se subjekti kishte pasur mundësi të investonte për dy këstet e para të kësaj pasurie, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare.

4.8 Për këstin e fundit paguar në datën 17.1.2012, gjatë hetimit, u vërejt se bashkëshorti i subjektit kishte tërhequr nga llogaria e tij bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, shumën 1.000.000 lekë, datë 2.11.2011. Meqenëse, nga data e tërheqjes së shumës deri në datën e pagesës së këstit, nuk rezultoi që subjekti apo familjarët të kishin kryer ndonjë investim tjetër, por edhe për faktin se burimi i krijimit të kësaj shume rezultoi i ligjshëm, pasi viti 2011 ishte mbyllur me balancë pozitive, Komisioni e mori në konsideratë këtë shumë, si të përdorur për pagesën e këstit të tretë dhe të fundit, të kësaj pasurie.

- ✓ Trupit gjykues, pas kryerjes së analizës financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor, i rezultoi se subjekti kishte pasur mundësi financiare të paguante këstin e tretë dhe të fundit të kësaj pasurie.

³⁸ Është vlerësuar të kryhet analiza vjetore, duke i përfshirë të dyja pagesat, pasi për këstin e paguar në datën 27.10.2011 nga analiza financiare e kryer nuk kanë rezultuar problematika.

4.8.i Ndërsa, lidhur me faktin që subjekti nuk kishte deklaruar shumën 1.000.000 lekë si gjendje *cash* në fund të vitit 2011, të tërhequr nga “Intesa Sanpaolo Bank”, nga bashkëshorti i saj, Komisioni i kërkoi të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

4.9 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka parashtruar se nga analiza e plotë financiare e vitit 2011, provohet se janë realizuar të ardhura të mjaftueshme për të përballuar të gjitha shpenzimet dhe blerjen e automjet “***”. Shuma prej 1.000.000 lekësh ka qenë në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortit, e grumbulluar prej pagave dhe është tërhequr në datën 2.11.2011, me qëllim pagesën e pjesës së mbetur të çmimit të automjetit “***”, në datën 17.1.2012, pagesë e këstit të tretë të automjetit. Cash-i i padeklaruar në fund të vitit, është rrjedhojë e shumave të tërhequra nga banka sa më sipër, pra, nga burime të ligjshme të cilat vijnë nga paga e bashkëshortit (në bankë pasqyrohet origjina e likuiditeteve të hyra), por, duke qenë se ato janë shpenzuar para deklarimit, nuk janë deklaruar si gjendje *cash*-i në banesë më 31 dhjetor, pra, nga ana financiare nuk është bërë ndarja e periudhës/cut off për deklarim, por që në momentin e deklarimit këto të ardhura kanë qenë të shpenzuara. Nga analiza financiare pozitive, e konfirmuar edhe prej Komisionit, konstatohet se kam pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj gjendjeje *cash*. Si rrjedhojë e kësaj qasje të pakujdesshme, këtë gjendje nuk e kam pasqyruar në DPV-në e vitit 2011. Nga analiza financiare pozitive, e konfirmuar edhe prej Komisionit, konstatohet se së bashku me bashkëshortin, për efekt të pagave, kam pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj gjendjeje *cash*. Vërtetësia e ekzistencës *cash* të kësaj shume dhe destinimi i përdorimit të saj, evidentohet dhe nga afria kohore e tërheqjes së shumës nga llogaria bankare e bashkëshortit tim, dhe përdorimit për pagesën e këstit të tretë të blerjes së automjetit, në datën 17.1.2012. Në këtë përfundim ka arritur edhe Komisioni duke parashtruar, në faqen 18 të materialit “rezultatet e hetimit administrativ” se “4.8 Për këstin e fundit paguar, datë 17.1.2012, gjatë hetimit, vihet re se bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga llogaria e tij bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 1.000.000 lekë, datë 2.11.2011. Meqenëse, nga data e tërheqjes së shumës deri në datën e pagesës së këstit, nuk rezulton që subjekti apo familjarët të kenë kryer ndonjë investim tjetër, dhe burimi i krijimit të kësaj shume e cila është tërhequr është i ligjshëm, pasi viti 2011 është mbyllur me një balancë pozitive, Komisioni e mori në konsideratë këtë shumë të përdorur për pagesën e këstit të tretë dhe të fundit të kësaj pasurie.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

4.10 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti në prapësime, vlerëson se mosdeklarimi i shumës 1.000.000 lekë, si gjendje *cash* në fund të vitit 2011, të tërhequr nga “Intesa Sanpaolo Bank” nga ana e bashkëshortit të saj, mbetet një pasaktësi në deklarim, për arsye se:

- i) Rezulton që kjo shumë është një tërheqje e vetme dhe jo si rezultat i disa tërheqjeve brenda vitit kalendarik.
 - ii) Burimi i krijimit të shumës së tërhequr është i ligjshëm dhe i akumuluar nga pagat.
 - iii) Nga analiza financiare ka rezultuar se viti 2011 është mbyllur me një balancë pozitive.
 - iv) Nga data e tërheqjes së shumës deri në datën e pagesës së këstit të fundit të automjetit, nuk rezultoi që subjekti apo familjarët të kishin kryer ndonjë investim tjetër.
 - v) Shuma e tërhequr është përdorur brenda një afati kohor të shkurtër dhe përpara dorëzimit të deklaratës periodike vjetore, çka krijon bindjen se pasaktësia e deklarimit lidhet me mos disponimin e kësaj shume përpara dorëzimit të deklaratës periodike.
- ✓ Nën këto argumente faktike, për sa më sipër, trupi gjykues, konkludon se kjo pasaktësi nuk ndikon në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit në këtë vendimarrje.

5. Automjet “*”,** kontratë shitje, datë 3.1.2014. Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor ***, datë 7.1.2014. Blerë me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “***”, me targa ***, automjetit tip “***” si dhe të ardhurat nga paga. Vler:a 18.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

5.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga DPSHTRr-ja.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

5.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, me përshkrimin “Kontratë blerje autoveture ***. Kontratë shitje, datë 3 janar 2014. Vlera: 18.000 euro”.

5.3 Në deklaratën *Vetting* për këtë pasuri, subjekti ka depozituar dokumentacionin përkatës³⁹.

Hetimi i kryer nga Komisioni

5.4 DPSHTRr-ja me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2020, informon se shtetasja Mariana Spiro Shegani, ka të regjistruar automjetin me targa ***.

5.5 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

5.5.i Subjekti, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, nuk e ka deklaruar burimin e kësaj pasurie, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklaroi se kanë shërbyer si burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip “***”, me targa ***, të automjetit “***”, si dhe të ardhurat nga paga.

5.6 Gjatë hetimit rezultoi se automjeti tip “***”, me targa ***, është shitur me kontratën e shitjes nr. ***, datë 7.10.2011, në vlerën 2.800 euro. Subjekti në deklaratën periodike të vitit 2011 nuk rezultoi të ketë deklaruar gjendje *cash*, apo mbartje të kësaj shume deri në vitin 2014, kur është investuar për këtë pasuri. Për pasojë, kjo shumë nuk mund të merret në konsideratë si burim krijimi i kësaj pasurie. Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “***” me targa ***, janë përfshirë nga Komisioni në analizën financiare të kryer për vitin 2011, vit në të cilin janë përfituar këto të ardhura. Për sa kohë që nga ana e subjektit nuk ka deklarime për gjendje *cash* të kursimeve të saj, presupozohet se ato janë shpenzuar dhe kursimet e vetme mbeten ato që disponohen në bankë në fund të vitit.

Ndërsa automjeti tip “***” është shitur me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 23.1.2014, në vlerën 5.500 euro.

5.7 Komisioni i ka kërkuar⁴⁰ subjektit dokumentacion mbështetës mbi likuidimin e kësaj pasurie dhe subjekti ka depozituar:

- vërtetim, datë 21.10.2020, të shoqërisë “***” sh.p.k;
- faturë tatimore shitje me nr. serie ***, nr. fature 1294, datë 03.01.2014, në vlerën 18.000 euro (konvertuar në 2.521.980 lekë);
- ditar klienti; si dhe
- ekstraktin e “Raiffeisen Bank” për shoqërinë “***” sh.p.k., ku identifikohen pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

5.8 Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se automjeti është likuiduar me tri këste, si vijon:

Tabela nr. 4

Datë	Shuma në euro
3.1.2014	10,000
11.2.2014	4,000

³⁹Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së

⁴⁰Pyetësor nr. ***, datë 20.10.2020.

25.4.2014	4,000
Total	18,000

5.8.i Vihet re se, për këstin e parë të paguar në datën 3.1.2014, në shumën 10.000 euro ose 1.401.000 lekë, subjekti është në pamundësi financiare për krijimin e të gjithë shumës së këtij kësti, pasi nuk rezulton që në deklaratën periodike të vitit 2013, të ketë deklaruar kursime *cash* apo të ketë kryer ndonjë tërheqje nga llogaritë bankare përpara likuidimit të kësaj shume.

5.8.ii Për pagesën e këstit të dytë, datë 11.2.2014, në shumën 4.000 euro, rezultoi se subjekti ka shitur në datën 23.1.2014, automjetin tip “***”, në shumën 5.500 euro. Të ardhurat nga shitja e këtij automjeti, subjekti i ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*.

5.8.iii Ndërsa, për këstin e tretë të paguar në datën 25.4.2014, në shumën 4.000 euro, gjatë hetimit rezultoi se subjekti ka tërhequr nga llogaria e saj në “Credins Bank” shumën 593.000 lekë, datë 24.0.2014, një ditë përpara pagesës së këstit fundit.

5.9 Pavarësisht analizimit të secilit këst, Komisioni kreu analizën financiare deri në datën 25.4.2014, kur ka përfunduar likuidimi i kësaj pasurie.

5.10 Komisionit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, i rezultoi se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi në shumën 1.736.848 lekë, për të investuar në këtë pasuri të luajtshme, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kaloi barrën e provës⁴¹ për të dhënë argumentet e saj në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

5.11 Subjekti në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka parashtruar se në lidhje me këtë pasuri Komisioni ka konstatuar se ka një diferencë të pajustificuar prej 1.736.848 lekësh, e cila në fakt, sipas dokumenteve bankare të pagave të bashkëshortit dhe subjektit, rezulton se është i justifikuar *cash*-i për investime për katër mujorin e parë /2014 si më poshtë. Komisioni ka konstatuar se çmimi i automjetit është likuiduar me tri këste, përkatësisht: 10,000 euro në datën 3.1.2014; 4,000 euro në datën 11.2.2014; si dhe 4000 euro në datën 25.4.2014.

Në lidhje me pagimin e këstit të parë në shumën 10,000 euro, në datën 3.1.2014, për të cilën Komisioni ka konstatuar se subjekti është në pamundësi financiare për krijimin e të gjithë shumës së këtij kësti, pasi nuk rezulton që në deklaratën periodike të vitit 2013, të ketë deklaruar kursime *cash* apo të ketë kryer ndonjë tërheqje nga llogaritë bankare përpara likuidimit të kësaj shume.

Parashtroj se, si rrjedhojë, e pagave mujore, kam patur gjendje monetare në llogarinë time bankare në “Credins Bank”, dhe në datën 25.10.2013, kam tërhequr nga kjo llogari shumën 915.000 lekë. Këtë shumë e kam mbajtur në gjendje, *cash*. Pasjen e kësaj gjendje *cash*, nga fakti që burimi ishte i ligjshëm, prej pagave, në mënyrë të pakujdesshme nuk e kam deklaruar. Kjo shumë është teprice *cash* në fund të vitit 2013. Fakti që këtë shumë e kam patur *cash*, të papërdorur, provohet dhe nga DPV-ja e vitit 2013, në të cilën janë deklaruar të gjitha shpenzimet e kryera gjatë vitit 2013. Për më tepër, nuk rezulton asnjë e dhënë tjetër nga cilido burim i ligjshëm apo e dalë nga hetimi administrativ, se unë kam përdorur këtë likuiditet për të krijuar ndonjë pasuri tjetër apo për të përballuar ndonjë shpenzim tjetër, veç atyre të deklaruara. Në plotësimin e shumës prej 10,000 euro kanë shërbyer dhe të ardhurat nga pagat të bashkëshortit gjatë vitit 2013. Në mbështetje të këtyre argumenteve, provohet burimi i ligjshëm i shumës prej 10.000 euro si pagesë e këstit të parë

⁴¹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

të automjetit. Ndonëse nuk i kam deklaruar gjendje cash-i në fund të periudhës 2013, por në fakt kam rehatuar gjendjet financiare më sipër, kam pasur likuiditete të mjaftueshme në fund të vitit 2013 për të kryer investime / shpenzimet, për 4 mujorin e parë të vitit 2014.

Sqaroj sërish se cash-i i padeklaruar në fund të vitit, është rrjedhojë e shumave të tërhequra nga banka sa më sipër, pra, nga burime të ligjshme të cilat vijnë nga paga e bashkëshortit dhe subjektit (në bankë pasqyrohet origjina e likuiditeteve të hyra), por, duke qenë se ato janë shpenzuar para deklarimit, nuk janë deklaruar si gjendje cash-i në banesë në datën 31 dhjetor, pra, nga ana financiare, nuk është bërë ndarja e periudhës/cut off për deklarim, por që në momentin e deklarimit këto të ardhura kanë qenë të shpenzuara. Në lidhje me pagimin e këstit të dytë në shumën 4,000 euro, në datën 11.2.2014, Komisioni ka konstatuar se pagesa e këstit të dytë është përballuar nga çmimi i shitjes së automjetit “***”, ashtu siç unë e kam deklaruar këtë fakt edhe në deklaratën Vetting, por, nga ana e Komisionit kjo e ardhur nuk llogaritet fare në analizën financiare të periudhës 1.1.2014 – 25.4.2014, të prezantuar në tabelën 12. Në këtë tabelë nuk rezulton që të jetë e përfshirë e ardhura prej 5.500 euro e përfituar nga shitja e automjetit “***”. Si rrjedhojë, subjekti ka kërkuar që këtë shumë ta përfshijë në analizën financiare, sepse përcakton burimin e ligjshëm, të vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme të pagesës së këstit të dytë.

Më tej, subjekti sqaron se: Në lidhje me pagimin e këstit të tretë në shumën 4,000 euro, në datën 25.4.2014, pagesa e këstit të tretë, siç e konstatojnë edhe Komisioni është përballuar nga tërheqja bankare e shumave, si më sipër, krijuar prej pagave mujore.

Në konkluzion, subjekti deklaron se nuk qëndron konstatimi i bërë nga Komisioni për balancën negative në shumën 1,736,848 lekë.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

5.12 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit në këto prapësime, arsyeton si vijon:

i) Pretendimi i subjektit se ka pasur gjendje cash në fund të vitit 2013 dhe me të ka paguar këstin e parë prej 10.000 euro të kësaj pasurie, nuk mund të merret në konsideratë, për faktin se ndryshe nga dy tërheqjet e tjera, në fund të vitit, të arsyetuara në këtë vendim për pasurinë nr. 4 dhe pasurinë nr. 6, në këtë rast shuma e tërhequr në datën 25.10.2013, jo vetëm që nuk korrespondon me këstin e paguar, por, edhe se data e tërheqjes me datën e përdorimit të saj relativisht pasqyrojnë një periudhë kohore të largët. Subjekti pretendon se ka pasur jo vetëm shumën prej 915.000 lekësh të tërhequr nga llogaria e saj bankare, por edhe shuma të tjera nga të ardhurat nga pagat e vitit 2013 të bashkëshortit, por pa e cilësuar saktësisht se sa mund të ketë qenë kjo gjendje. Trupi gjykues, këtë pretendim nuk e ka marrë në konsideratë, pasi në zbatim të ligjit nr. 9049/2003 i ndryshuar, i cili ka parashikuar detyrimin e subjekteve deklaruese, ku sipas tij, subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to; [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj; dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale; [...] nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar saktë gjendjen e saj të likuiditeteve.

ii) Ndërsa, trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit, vlerëson se konstatimi i subjektit mbi mospërfshirjen e të ardhurave nga shitja e automjetit tip “Citroen C2” është i drejtë dhe, për pasojë, duhet marrë në konsideratë në përlllogaritjet financiare.

-Në përfundim të analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, duke mos përfshirë gjendjen cash të pretenduar, por duke marrë në konsideratë të ardhurat nga shitja e automjetit,

subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare, në shumën 966.243 lekë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

6. Apartament me sip. 102.98 m², në rr. “D. P.”, lagjja nr. *, Pogradec**, me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.5.2015, blerë me të ardhurat nga pagat. Vlera: 35.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

6.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja Pogradec dhe DPPP-ja.*

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

6.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 me përshkrimin “*apartament me sip. 102.98 m², rr. ‘D. P.’, lagjja nr. ***, Pogradec. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.5.2015. Vlera: 35.000 euro*”.

6.3 Subjekti në lidhje me këtë pasuri ka depozituar në deklaratën *Vetting* dokumentacion mbështetës⁴².

Hetimi i kryer nga Komisioni

6.4 ZVRPP-ja Pogradec⁴³ informon se shtetasi Ilir Shegani ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë me të dhënat: “*Pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë apartament me sip. 102.98 m²*”.

6.5 FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020, informon se me gjeneralitetet I. Sh., referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet abonent me kontratën e furnizimit me nr. *** në instancën Pogradec.

6.6 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

6.6.i Subjekti, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklaroi se është blerë me të ardhurat nga pagat.

6.6.ii Dokumentacioni i ZVRPP-së Pogradec konfirmon të dhënat në kontratën e shitjes për likuidimin e kësaj pasurie, konkretisht vlerën 35.000 euro. Sipas kësaj kontrate, në datën 8.1.2015 është paguar shuma 15.000 euro dhe në datën 8.5.2015 shuma 20.000 euro. Të dyja këto shuma janë derdhur *cash* nga bashkëshorti i subjektit në llogarinë bankare të noterit në “Raiffeisen Bank”.

6.7 Nga korrespondenca e Komisionit me bankat e nivelit të dytë vihet re se përpara likuidimit të kësaj pasurie bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga llogaria e tij bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” shumat si më poshtë:

- në datë 30.12.2014 shumën 2.000.000 lekë;
- në datë 26.1.2015 shumën 1.800.000 lekë;
- në datën 9.3.2015 shumën 300.000 lekë.

6.8 Ndërsa subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e saj në “Credins Bank” në datën 22.1.2015 shumën 689.000 lekë.

6.9 Subjekti, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, nuk e ka deklaruar si gjendje *cash* shumën prej 2.000.000 lekësh të tërhequr nga bashkëshorti i saj në datën 30.12.2014, e cila ka shërbyer si burim për likuidimin e kësaj pasurie të parë në datën 8.1.2015 në vlerën 15.000 euro.

6.10 Komisioni kreu analizën financiare deri në datën kur është likuiduar totalisht kjo pasuri, duke marrë në konsideratë tërheqjet e kryera nga subjekti dhe bashkëshortit të saj.

⁴² Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴³ Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së, shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2017.

- ✓ Trupit gjykues, pas kryerjes së analizës financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor, i rezultoi se subjekti kishte pasur mundësi financiare të investonte në këtë pasuri, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare.

6.11 Komisioni, nga dokumentacioni i administruar vërejtë se subjekti: nuk e kishte deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015; dhe se nuk kishte deklaruar shumën 2.000.000 lekë si gjendje *cash* në fund të vitit 2014, të tërhequr datën 30.12.2014 nga “Intesa Sanpaolo Bank” nga bashkëshorti i saj dhe, për pasojë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

6.12 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera në prapësimet e saj, ka shpjeguar se: *“i. Mungesa e deklaratimit ka ardhur si pasojë e pakujdesisë, ka munguar qëllimi dhe motivi për të fshehur burimin e krijimit, kur e gjithë vlera e investimit është siguruar nga pagat e mia dhe të bashkëshortit, lehtësisht të verifikueshme dhe të gjurmueshme. Kjo del në pah edhe nga konstatimi i Komisionit që subjekti ka pasur mundësi financiare të investoj në këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare. Burimin e krijimit të kësaj pasurie e kam deklaruar në deklaratën Vetting. ii. Për sa i përket konstatimit se nuk është deklaruar shuma cash në vlerën 2.000.000 lekë në fund të vitit 2014, deklaroj se kjo shumë është tërhequr në datën 30.12.2014 nga ‘Intesa Sanpaolo Bank’ nga ana e bashkëshortit. Sa rezultoi dhe nga hetimi administrativ, burimi i krijimit të kësaj shume përbëhet nga pagat. Tërheqja nga banka është kryer në datën 30.12.2014, me synim pagesën e këstit të parë të çmimit të kësaj pasurie. Nga analiza financiare që bëhet për vitin 2014 provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm burimi i ligjshëm për krijimin e kësaj shume të investuar në blerjen e apartamentit dhe të deklaruar në deklaratën Vetting. Në analizë të fakteve të lartpërmendura dhe parashikimeve ligjore, dëshmohet se unë nuk kam bërë përpjekje për të fshehur shumën 2.000.000 lekë, apo për ta paraqitur në mënyrë të pasaktë. Qëllimi, si element i anës subjektive, është përcaktues në këtë drejtim. Jo pa qëllim, Kushtetuta ka përdorur fjalën ‘përpiket’. Prandaj, ky rast duhet dalluar nga rastet kur pasaktësia në deklaratim ka ardhur si rrjedhojë e pakujdesisë në plotësimin e deklaratës, siç më ka ndodhur. Në këtë rast mungon ana subjektive që kërkon rregullimi kushtetues i pikës 5 të nenit D.”*

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

6.13 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti në prapësime, vlerëson se mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurisë, objekt i hetimit administrativ në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, mbetet një pasaktësi, pasi subjekti e ka deklaruar me plotësi në deklaratën *Vetting* burimin e krijimit të kësaj pasurie.

6.14 Ndërsa, lidhur me mosdeklarimin e shumës prej 2.000.000 lekësh si gjendje *cash* në fund të vitit 2014, të tërhequr nga “Intesa Sanpaolo Bank” nga bashkëshorti, trupi gjykues sërish çmon se ndodhet përpara një tjetër pasaktësie në deklaratim. Subjekti gjendet në të njëjtën situatë të arsyetuar nga trupi gjykues në pasurinë nr. 4 të këtij vendimi. Madje në këtë rast diferenca kohore nga data e tërheqjes me përdorimin e shumës 2.000.000 lekë është vetëm 1 javë.

6.15 Trupi gjykues, për të mos rënë në përsëritje, konkludon se subjekti në tërësi në këtë vendimmarrje karakterizohet nga disa pasaktësi, për të cilat rast pas rasti është arsyetuar dhe ku disa prej tyre nuk mund të anashkalohen në vlerësimin tërësor bazuar në analizën specifike të fakteve dhe, për rrjedhojë, në pasojën që passjell.

7. Llogari nr. * në “Credins Bank” në lekë, për të ardhurat nga paga. Vlera: 520.955,68 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

7.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank.*

7.2 “Credins Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 18.8.2020, konfirmon llogari page në emër të znj. Mariana Shegani (Dedi), me gjendje në datën 23.1.2017 në vlerën 520.955,68 lekë.

✓ Trupit gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

8. Gjendje cash në banesë në euro, akumuluar nga pagat në vlerën 11.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, lidhur me të ardhurat, shpenzimet dhe investimet e vitit 2016, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të kursejë shumën 11.000 euro.

Detyrimet financiare

9. Kredi hipotekore për blerje apartamenti në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 52.000 USD, me datë fillimi 6.8.2003 deri më 6.8.2018, me kontratë nr. ***, datë 25.7.2003, me normë interesi aktual 4.48 %, me këst mujor 440 USD. Hipoteka është marrë përsipër nga sipërmarrësi sipas kontratës, nr. ***, datë 2.11.2004. Shuma e detyrimit financiar: 8.445,79 USD.

9.1 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2020, konfirmon kredi në USD në emër të shtetasit I. Sh., me gjendje detyrimi në datën 23.1.2017 në vlerën 8.039,10 USD.

Kredia konfirmohet me kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 25.7.2003, me palë kredidhënëse “Banka Amerikane e Shqipërisë” dhe palë kredimarrëse I. Sh. dhe bashkëkredimarrëse Mariana Shegani, të shumës 52.000 USD për blerjen e një apartamenti të ri.

9.2 Komisioni, kredinë që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 112.22 m² në Tiranë, e ka trajtuar në pasurinë nr. 1 të këtyre rezultateve.

✓ Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit, konstatoi se megjithëse nuk përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank” lidhur me detyrimin e mbetur pasi subjekti nuk e ka përfshirë këstin e paguar për muajin janar 2017, ky konstatim nuk merr peshë apo nuk përbën problematikë në vlerësimin tërësor në këtë vendimmarrje.

9.3 Komisioni hetoi edhe lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit të subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksionit të saj në raport me shoqëritë ku ka blerë pasuritë e paluajtshme apo edhe me përfaqësuesit e tyre, si palë ndërgjyqëse.

9.4 Në këtë drejtim, nga korrespondenca⁴⁴ e mbajtur me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti ka ushtruar pa ndërprerje detyrën e saj si gjyqtare prej vitit 1992, nuk është konfirmuar ndonjë proces gjyqësor, civil, tregtar, administrativ, familjar, etj., i gjykuar prej saj me palët e sipërpërmendura. Në këto kushte, trupi gjykues nuk konstaton problematikë në lidhje me këtë komponent.

9.5 Gjithashtu, lidhur edhe me ekzistencën e ndonjë trajtimi preferencial në përfitimin me kosto të pasurive të paluajtshme, të cilat i ka porositur apo blerë nga shoqëritë ndërtimore, në raport me çmimet e pasqyruara nga EKB-ja⁴⁵, trupit gjykues nga hetimi nuk i rezultoi që subjekti të gjendej në kushtet e trajtimit preferencial në përfitimin e pasurive.

9.6 Deklarimi i bashkëshortit të subjektit, z. I. Sh.:

⁴⁴ Me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2020, të Komisionit dhe nr. *** prot., datë 5.11.2021 dhe nr. *** prot., datë 11.1.2021.

⁴⁵ <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit/>

- Apartament me sip. 113 m², në rrugën “M. Sh.”, Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 31.10.2002, me nr. *** rep. Kontrata e kredisë bankare nr. ***, datë 25.7.2003, blerë me kredi. Vlera: 50.820 USD. Pjesa takuese: 50%.
- Garazh me sip. 23.5 m², në rrugën “M. Sh.”, Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 10.8.2004, me nr. *** rep., blerë me të ardhurat nga pagat. Vlera: 8.000 USD. Pjesa takuese: 50%.
- Apartament me sip. 87.50 m², në K., Kavajë, sipas kontratës së porosisë datë 17.3.2008. Kontratë shitjeje trualli datë 3.12.2015, me nr. ***, blerë me të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 45.5 m² në K. dhe nga pagat. Vlera: 35.000 euro dhe 335.360 lekë. Pjesa takuese: 50%.
- Automjet tip “****”, me kontratë shitblerjeje fat. nr. ***, datë 5.5.2011. Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor ***, datë 5.5.2011. Blerë me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****” me targa ***, automjetit tip “****” me targa *** dhe të ardhurat nga pagat. Vlera: 31.500 euro. Pjesa takuese: 50%.
- Automjet tip “****”, Kontratë shitje, datë 3.1.2014. Certifikata e pronësisë së automjetit rrugor ***, datë 7.1.2014. Blerë me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****” ***, e automjetit tip “****”, si dhe të ardhurat nga paga. Vlera: 31.500 euro. Pjesa takuese: 50%.
- Apartament me sip. 102.98 m², në rrugën “D. P.”, lagjja nr. 1, Pogradec, me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.5.2015, blerë me të ardhurat pagat. Vlera: 35.000 euro. Pjesa takuese: 50%.
- Gjendje *cash* në banesë në euro, akumuluar nga pagat në vlerën 11.000 euro. Pjesa takuese: 50%.
- Kredi hipotekore për blerje apartamenti në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 52.000 USD, me datë fillimi 6.8.2003 deri më 6.8.2018, me kontratë nr. ***, datë 25.7.2003, me normë interesi aktual 4.48 %, me këst mujor 440 USD. Hipoteka është marrë përsipër nga sipërmarrësi sipas kontratës së hipotekës nr. ***, datë 2.11.2004. Shuma e detyrimit financiar: 8.445,79 USD.
- ✓ Meqenëse të gjitha pasuritë dhe detyrimet e sipërcituara nga bashkëshorti janë të njëjtat pasuri apo detyrime të deklaruara nga subjekti, si dhe të krijuara gjatë regjimit martesor, trupi gjykues nuk vlerësoi të ripërsëritet në vendimmarrje, pasi i ka analizuar dhe ka konkluduar për secilën prej tyre më sipër.

10. Llogari bankare nr. * në “Intesa Sanpaolo Bank” në USD, e cila përdoret për pagesat e kësteve të kredisë. Vlera: 998,26 USD. Pjesa takuese: 100%.**

10.1 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2020, konfirmon llogari rrjedhëse në USD në emër të shtetasit I. Sh., me gjendje në datën 23.1.2017, në vlerën 998,26 USD.

- ✓ Trupi gjykues, pas verifikimit të dokumentacionit, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

11. Llogari bankare nr. * në “Intesa Sanpaolo Bank” në lekë, e cila është hapur nga “****” sh.a., për derdhjen e pagës. Vlera: 705.561,27 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

11.1 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2020, konfirmon llogari rrjedhëse në lekë në emër të shtetasit I. Sh. me gjendje në datën 23.1.2017, në vlerën 705.561,27 lekë.

- ✓ Trupit gjykues, pas verifikimit të dokumentacionit, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

12. Llogari bankare nr. * në “Intesa Sanpaolo Bank” në lekë,** e cila është lidhur me kartën *** të subjektit. Vlera: 103.514,60 lekë. Pjesa takuese: 100%.

12.1 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2020, konfirmon llogari rrjedhëse në lekë në emër të shtetasit I. Sh. me gjendje në datën 23.1.2017, në vlerën 103.514,60 lekë.

✓ Trupi gjykues, pas verifikimit të dokumentacionit, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

Gjetje të tjera lidhur me pasuri të luajtshme/automjete

Komisionit i rezultoi se subjekti kishte investuar në disa pasuri të luajtshme që, ashtu siç është vënë re edhe gjatë hetimit, shitja e tyre është deklaruar nga subjekti si burim krijimi.

Komisioni ka vlerësuar të kryejë analizë financiare për secilën prej tyre.

13. Automjet tip “**”, me targa ***, blerë në shumën 500.000 lekë**

13.1 Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk e deklaroi këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003. Automjeti konfirmohet me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 7.10.1996, me palë shitëse A. A. dhe palë blerëse bashkëshortin e subjektit, për automjetin tip “****” me nr. shasie ***, me targa ***, në vlerën 500.000 lekë. Kjo pasuri nuk disponohet më nga subjekti, pasi është shitur në vitin 2005 dhe është deklaruar prej saj si burim krijimi për pasurinë automjet tip “****” (analizuar në pikën nr. 4 të vendimit).

13.2 Komisioni, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare me të ardhurat dhe shpenzimet e përfituara përgjatë periudhës 1992 – 1996, nga ku rezultoi se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 240.126 lekë për të investuar në këtë pasuri, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kaloi barrën e provës⁴⁶ për të dhënë argumentet në lidhje me konstatimet e bëra.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

13.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim të pasqyruar për pasurinë nr. 3, pasi është një investim i kryer në atë periudhë dhe se është mbuluar me të ardhurat e dhuruara nga nëna e bashkëshortit, të përfituara prej saj si rezultat i dhënies me qira të pasurisë që kishte në pronësi.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

13.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, faktit që: (i) kjo pasuri nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2003 për shkak se e dispononte atë; (ii) nuk është deklaruar shitja e saj në vitin 2005, nga e cila kanë buruar të ardhura; apo edhe (iii) për rëndësinë që merr përdorimi i shumës së përfitur në burimin e krijimit të pasurisë automjet tip “****”, çmon se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me këtë pasuri. Për sa kohë që trupi gjykues nuk i mori në konsideratë, pra nuk i përfshiu në përlllogaritje të ardhurat e përfituara nga qiraja, rezultati financiar në këtë rast mbetet i pandryshueshëm. Nga ana tjetër, rezultoi se balanca negative është relativisht e ulët në raport me të ardhurat e përfituara dhe shpenzimet e kryera për këtë vit kalendarik. Trupi gjykues, në përfundim çmon se kjo balancë nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes për të penalizuar subjektin në vendimmarrjen ndaj tij.

14. Automjetit tip “**”, me targa ***, blerë në shumën 250.000 lekë**

14.1 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, me përshkrimin “*autoveturë *** ***, vlera 250.000 lekë. Burimi i krijimit: me kursimet nga pagat*”.

⁴⁶ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Ky automjet konfirmohet me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 23.9.2003, me palë shitëse A. L. dhe palë blerëse Mariana Shegani (Dedi) për automjetin tip “****”, me nr. shaspie ***, me targa P-37-24 DR, në vlerën 250.000 lekë dhe është deklaruar nga subjekti si burim krijimi për pasurinë automjet tip “****” (analizuar në pikën nr. 4 të vendimit).

- ✓ Trupit gjykues, pas analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor për periudhën 16.2.2003 – 23.9.2003, konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në blerjen e kësaj pasurie, si dhe të kryejë shpenzimet e tjera familjare.

15. Automjet i markës “**”, tip ***, me targa ***, blerë në shumën 300.000 lekë**

15.1 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, me përshkrimin “*automjet tip ***, vlera 6.500 euro, 300.000 lekë*”.

15.2 Ky automjet konfirmohet me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.4.2004, me palë shitëse H. H. dhe palë blerëse I. Sh., për automjetin e markës “****”, tip ***, me nr. shaspie ***, në vlerën 300.000 lekë.

15.3 Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në⁴⁷, përveç kontratës së shitjes është e administruar edhe deklarata e zhdoganimit të automjetit. Sipas kësaj deklarate që daton më 22.4.2004 (2 ditë pasi është hartuar kontrata e shitjes), çmimi i automjetit pasqyrohet në vlerën 3.500 euro dhe mbi këtë vlerë janë përlllogaritur edhe detyrimet doganore. Në total, për zhdoganimin e automjetit, është paguar shuma 249.169 lekë.

15.4 Meqenëse Komisioni ka konstatuar vlera të ndryshme në deklarin periodik në raport me kontratën e shitblerjes, ka pyetur⁴⁸ subjektin lidhur me vlerën reale të shpenzuar për blerjen e automjetit.

15.5 Subjekti, në përgjigje të tij, ka sqaruar se shuma e shpenzuar për blerjen e automjetit është vlera 300.000 lekë, e përcaktuar në kontratën e shitjes nr. ***, datë 20.4.2004, si dhe pagesa në shumën 249.660 lekë për zhdoganimin e automjetit. Gjithashtu, ka deklaruar se *shuma 6.500 euro është lapsus, nga dokumentet shoqëruese të automjetit.*

15.6 Komisioni kreu analizën financiare, duke përfshirë zhdoganimin e automjetit, si dhe vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes, nga ku i rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të investojë në këtë pasuri, si dhe të kryejë shpenzimet e tjera familjare.

15.7 Por për faktin se dukej se çmimi i vendosur në kontratën e shitjes prej 300.000 lekësh ishte më i vogël se vlera 3.500 euro ose 455.805 lekë⁴⁹ mbi të cilën është zhdoganuar automjeti, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

15.8 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar se automjeti është blerë në shtetin italian. Sjellja e automjetit në Shqipëri shoqërohet edhe me disa shpenzime, si: shpenzime noterie; shpenzime ndërrim pronësie; shpenzime siguracion udhëtimit, karburanti; shpenzime trageti; taksë rruge dhe dogana. Shuma e këtyre shpenzimeve, të cilat janë paguar para marrjes së automjetit, përbëjnë edhe diferencën e çmimit.

- ✓ Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, konkludon se në tërësi pretendimet qëndrojnë dhe se, për pasojë, nuk konstatohen problematika të cilat mund të marrin peshë në këtë vendimmarrje.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 12.5.2020.

⁴⁸ Pyetësor nr. ***, datë 20.10.2020.

⁴⁹ Kurs këmbimi është vendosur ai i deklaratës doganore.

16. Automjet tip “*”,** blerë në vlerën 13.000 euro ose ekuivalenti në vlerën 1.626.300 lekë me TVSH.

16.1 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, me përshkrimin “automjet ***, vlera 13.000 euro”.

16.2 Ky automjet konfirmohet me faturën tatimore të shitjes nr. ***, me shitës “***” dhe blerës Mariana Shegani, datë 30.1.2007, për automjetin tip. “***” me nr. shasie ***, në vlerën 13.000 euro ose ekuivalenti 1.626.300 lekë me TVSH.

16.3 Lidhur me likuidimin e kësaj pasurie, në pyetësorin standard, subjekti ka depozituar dy mandatarkëtimi, përkatësisht, mandatarkëtimi nr. ***, datë 31.1.2007, në shumën 10.000 euro, me përshkrimin “parapagim automjet ***” dhe mandatarkëtim nr. ***, datë 14.2.2007, në shumën 3.000 euro me përshkrimin “plotësim pagese”.

16.4 Gjatë hetimit ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga llogaria e tij bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” shumën 1.260.000 lekë, në datën 30.1.2007, e cila duket se ka shërbyer për likuidimin e mandatit të parë.

16.5 Komisioni, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare deri në datën 14.2.2007, kur ka përfunduar së likuiduari kjo pasuri nga ku i rezultoi se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 101.292 lekë për të investuar në këtë pasuri, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare dhe për pasojë i kaloi subjektit barrën e provës⁵⁰, për të dhënë argumentet në lidhje me konstatimet e bëra.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

16.6 Subjekti, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar se *të ardhurat e bashkëshortit, sipas statement-it të bankës përkatëse, për periudhën janar 2007 – 15.2.2007, kanë qenë pagë për këtë periudhë, përkatësisht: $115.406 + 111.742 / 2 + \text{ushqime } 15.000 + 15000 / 2 = 193.777 \text{ lekë} - 145.406 \text{ lekë llog. Nga Komisioni konstatohet aritmetikisht një diferencë të ardhurash më pak prej } 48.371 \text{ lekësh. Në vitet } 2006 - 2007 \text{ ka pasur të ardhura dhe tepriçë të ardhurash mbi shpenzimet në vlerë të konsiderueshme,... diferenca vlerore e mësipërme sipas subjektit nuk është shifër materialiteti në lidhje me aq shumë tepriçë burimesh të ardhurash nga pagat në sistemin bankar.}$*

Subjekti, përveç se ka dhënë shpjegimet e mësipërme, është shprehur se: “(i) kam deklaruar me saktësi dhe plotësi pasuritë e mia dhe të personave të lidhur, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës; (ii) kam dorëzuar deklaratën e pasurisë në të cilën kam arritur të shpjegoj në mënyrë të arsyetuar financiarisht dhe ligjërisht burimin e pasurive të mia; (iii) nuk jam përpjekur, me ndërgjegjen time, të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi; (iv) pasuria e krijuar gjatë periudhës së rivlerësimit në raport me të ardhurat justifikohet në mënyrë tërësorë, të konfirmuar dhe nga përllogaritjet 2003 - 2016.”

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

16.7 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe përllogaritjeve të pasqyruara prej saj, konstaton se vlerat e cituara nuk bazohen në dokumentacion justifikues, ndërsa përllogaritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti janë bazuar në të dhënat e pasqyruara në *statement-in* bankar. Nga ana tjetër, fakti që balanca negative e konstatuar në momentin e pagimit të vlerës së automjetit është në vlerë minimale në raport me të ardhurat e përfituara dhe shpenzimet e kryera për këtë vit kalendarik, por edhe për shkak të balancës

⁵⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

pozitive në nivel vjetor, trupi gjykues çmon se ajo nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes për të penalizuar subjektin në vendimmarrjen ndaj saj.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin raportin mbi kontrollin e figurës nr. 11789, datë 31.10.2017, të deklasifikuar me vendim nr. 303, datë 27.10.2020, të KDZH-së.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi).

Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi), arrin nivel të besueshëm, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti është përgatitur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve nga raporti i vlerësimit të aftësive profesionale, hartuar nga grupi përkatës i punës, i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLGJ. Në përfundim të trajtimit të secilit grup të burimeve të informacionit, raporti ka konkluduar për secilin komponent si vijon:

1. Aftësitë profesionale

- a) *Njohuritë ligjore*

Subjekti Mariana Shegani ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës të procesit të rregullt ligjor, ndonëse në tekstin e vendimeve përfundimtare i përdor në raste të rralla. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit ajo përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë. Ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve civile në funksion të zgjidhjes së saktë të çështjes dhe është e aftë të identifikojë rastet kur zbatohet ligji specifik apo ligji më i hershëm në kohë. Në çështjet civile të analizuar është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes. Ka njohuri të procedurave të gjykimit në raport me llojin e çështjeve gjyqësore civile që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit dhe deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi ajo i respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, por jo gjithmonë i ka përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil apo ato të legjislacionit procedural penal.

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila, kur është rasti, plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë. Një tipar i mirë i punës së saj është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetim të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara që të jetë cenuar vendim nga gjykata e apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët. Gjithashtu, tek pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, por jo gjithmonë duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në tërësi në këtë komponent konstatohet se gjyqtarja Mariana Shegani në përgjithësi ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ajo ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, prapësimet e tyre, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar i palëve dhe deri tek shpallja e vendimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Është konstatuar se dosjet janë të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e paraqitura nga palët dhe më pas ato të krijuara nga gjykata, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët. Aktet janë administruar në referencë të rregullave procedurale civile apo penale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Mariana Shegani. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit Mariana Shegani. Nuk janë konstatuar raste që subjekti të mos ketë respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Mariana Shegani komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, ashtu edhe në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e saj.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Mariana Shegani për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në të tetë rastet ka qenë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile dhe penale.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti Mariana Shegani, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë në 13 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 22 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve ku ajo ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomës civile.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për subjektin e rivlerësimit nuk rezultojnë të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

C/1 RIVLERËSIMI PROFESIONAL

Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi të gjithë dokumentacionin e depozituar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit, ka konstatuar si vijon:

a. Në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti, të llojit vendim gjyqësor, rezultoi se një vendim civil i përket vitit 2013⁵¹, i dyti vitit 2014⁵² dhe vendimi i tretë viti 2015⁵³.

Rezultoi se të tri vendimet janë ankimuar dhe gjykata e apelit ka vendosur *lënien e tyre në fuqi*. Në tërësi nga analiza e tyre, sikurse i ka rezultuar edhe KLGj-së, është ndjekur një strukturim i qartë i ndarjes së pjesëve të vendimit, por edhe i arsytimit të tyre. Po ashtu, rezultoi se në vendimmarrje janë parashtruar aspekte procedurale për kërkimet dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse lidhur me objektin e kërkit dhe juridiksionin e kompetencës. Gjithashtu, rezultoi se janë përmendur dhe analizuar në arsyetim norma të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, ligje të tjera të posaçme, referuar bazueshmërive ligjore të kërkimeve të palëve, si dhe vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Vërehet se të tri vendimet paraqiten të standardizuar në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës.

b. Për sa i përket pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, në përgjithësi nuk kanë rezultuar problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

b.i Vërehet se dosjet (1⁵⁴, 2⁵⁵ dhe 4⁵⁶) e cilësuar me këtë numër rendor në raport, së bashku me vendimet përfundimtare, janë depozituar në kryesekretari jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

b.ii Për sa i përket ligjërimit të vendimeve nga gjykatat e shkallëve më të larta, rezultoi se vendimet ose nuk janë ankimuar, sikurse ka ndodhur me vendimin e dosjes nr. 1, ose janë ankimuar dhe kanë mbetur në fuqi në gjykatën e apelit, sikundër në disa raste edhe ndaj apelit rezultoi se është ushtruar rekurs, porse çështjet vijojnë ende të jenë në pritje të zhvillimit të gjykimin.

b.iii Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve⁵⁷ rezultoi se në dosjen nr. 1 gjykimi nga subjekti ka zgjatur gjithsej 5 vjet, 1 muaj e 20 ditë, në intervalin kohor 9.11.2010 – 29.12.2015, kohëzgjatje kjo jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e” e pikës 5 të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. I njëjti konstatim është vërejtur edhe në dosjen nr. 2 dhe nr. 4, ku gjykimi i çështjes nga subjekti ka

⁵¹ Dokumenti 1 – vendimi civil nr. ***, datë 17.6.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit K. G. G., me të paditur “E.” sh.a., person i tretë shoqëria “V.” sh.p.k., me objekt “detyrimin për pagimin e shumës së siguruar...”.

⁵² Dokumenti 2 – vendimi civil nr. ***, datë 4.6.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit të kundërpaditur shoqëria “E.” sh.p.k., me të paditur kundërpaditës shoqëria “A. E.” sh.p.k., me objekt të padisë “pagimin e vlerës së shitblerjes dhe dëmit të shkaktuar nga vonesat” dhe objekt të kundërpadisë “pagimin e vlerës së shitblerjes, dëmit të shkaktuar nga vonesat dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë”.

⁵³ Dokumenti 3 – vendimi civil nr. ***, datë 10.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit H. R., me të paditur N. R., persona të tretë A. R., etj., me objekt “detyrimin për njohjen trashëgimtar të trashëgimlënësës F. V. në ¼ të pasurisë, etj...”.

⁵⁴ Dosja 1, që i përket çështjes civile me nr. *** regj., datë 8.11.2010, me paditësi A. D., kundër të paditurve P. B. dhe F. G., persona të tretë “I. S. B.”, “T. B.”, “E. B.”, shoqëria “R. P.” sh.a. dhe Xh. R., me objekt “zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë absolute të vendimit datë 19.8.2006 dhe vendimit datë 7.5.2008 të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë “R. P.” sh.a. dhe veprimeve...”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 29.12.2015, depozituar pas 29 ditëve nga shpallja e vendimit.

⁵⁵ Dosja 2, që i përket çështjes civile nr. *** regj., datë 14.6.2012, me paditës Y. Y., të paditur shoqëria “A.” sh.p.k. dhe Y. L., me objekt të padisë “detyrimin për pagimin e shumës së bashku me interesat ligjore ...”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 23.7.2014, depozituar pas 1 muaji e 9 ditëve nga shpallja.

⁵⁶ Dosja 4, që i përket çështjes civile nr. *** regj., datë 4.7.2014, me paditës L. T., A. B. dhe F. T., kundër të paditurve AKKP, S. T., Z. T., A. T. dhe A. T., persona të tretë L. T., etj., me objekt “shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 27.2.2001 të KKP-së Tiranë...”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 26.9.2016, depozituar pas 1 muaji e 2 ditëve nga shpallja.

⁵⁷ Për më shumë referohuni edhe përmbajtjes së raportit të vlerësimit profesional të kryer nga KLGJ-ja.

zgatur përkatësisht 2 vjet, 1 muaj e 8 ditë, në intervalin kohor 15.6.2012 – 23 .7.2014 dhe 2 vjet, 2 muaj e 18 ditë, në intervalin kohor 8.7.2014 – 26.9.2016.

Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit duket se nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

c. Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime për sa përshkruhet në pikën “b.iii” të vendimit.

c.i Subjekti, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit të dosjeve ekziston një jurisprudencë e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese lidhur me përcaktimin e kriterëve, cenimi i të cilave passjell shkelle të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Kjo gjykatë ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit⁵⁸. Subjekti ka marrë në analizë secilën dosje, duke u përqendruar tek vlerësimi i kompleksitetit të çështjeve ku marrin rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (shihni vendimin nr. 45, datë 19.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Subjekti ka sqaruar se objekti i gjykimit të mosmarrëveshjes që i përket dosjes nr. 1⁵⁹ ka qenë i natyrës tregtare. Objekti i saj lidhet me zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë absolute të vendimit datë 19.8.2006 dhe vendimit datë 7.5.2008 të Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë “R. P.” sh.a., duke fshirë regjistrimet e kryera ne QKR-ja për këto vendime dhe ato vijuese, ku janë cituar 17 fshirje regjistrimesh. Çështja konkrete, në referim të objektit, paraqet rrethana të veçanta, komplekse që justifikojnë vonesë në shqyrtimin e saj. Në mbështetje të të drejtave të palëve në proces, gjykata ka disponuar me vendimmarrje disa herë në lidhje me kundërpadinë e paraqitur nga pala e paditur (pranuar për shqyrtim kundërpadinë, pushuar, ripranuar për shqyrtim mbas pushimit...), veprime këto të cilat kanë sjellë shtyrjen në kohë të shqyrtimit, për shkak të komunikimit të ndryshimeve të palëve në mungesë dhe në vijim njoftimi i palëve për ndryshimet ka dështuar, për shkak se komunikimet për disa palë ktheheshin të pakonfirmuara si pasojë e mosfunksionimit të rregullt të shërbimit postar. Po ashtu, subjekti ka analizuar hollësisht edhe interesin dhe sjelljen e palëve, pasi kanë kërkuar kohë për zgjidhjen e çështjes jashtëgjyqësisht, duke kërkuar disa herë pezullimin në mbështetje të nenit 297/b të Kodit të Procedurës Civile. Subjekti gjithashtu ka sqaruar se lidhur me sjelljen e autoriteteve si gjyqtare ka marrë masa të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme.*

Në lidhje me dosjen nr. 2⁶⁰ subjekti ka sqaruar se vonesa ka ardhur nga sjellja e palëve. Subjekti ka evidentuar se palët kanë bërë kërkesa për saktësimin e objektit të padisë disa herë, kërkesë për rregullim të ndërgjyqësisë, pasi gjykata ka urdhëruar kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (koha

⁵⁸ Vendimi nr. 45, datë 19.7.2016, i Gjykatës Kushtetuese; vendimi nr. 59, datë 16.9.2016, i Gjykatës Kushtetuese; vendimi nr. 1, datë 21.1.2016, i Gjykatës Kushtetuese; vendimi nr. 9, datë 14.2.2014, i Gjykatës Kushtetuese; vendimi nr. 14, datë 15.4.2010, i Gjykatës Kushtetuese etj.

⁵⁹ Çështja civile me nr. *** regj., datë 8.11.2010, me paditës A. D., kundër të paditurit P. B. dhe F. G., persona të tretë “I. S. B.”, “T. B.”, “E. B.”, shoqëria “R. P.” sh.a. dhe Xh. R., me objekt “zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë absolute të vendimit datë 19.8.2006 dhe vendimit datë 7.5.2008 të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë “R. P.” sh.a. dhe veprimeve...”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 29.12.2015, depozituar pas 29 ditëve nga shpallja e vendimit.

⁶⁰ Që i përket çështjes civile nr. *** regj., datë 14.6.2012, me paditës Y. Y., të paditur shoqëria “A.” sh.p.k. dhe Y. L., me objekt të padisë “detyrimin për pagimin e shumës së bashku me interesat ligjore ...”, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 23.7.2014, depozituar pas 1 muaji e 9 ditëve nga shpallja.

e gjykimit sipas ligjit procedural të pandryshuar), kërkesë për prova, etj. Po ashtu, ka sjellë si problematikë edhe ndryshimin e avokatëve përfaqësues në gjykim (të palës së paditur).

Edhe në lidhje me dosjen nr. 4⁶¹, subjekti ka sqaruar se kjo çështje ka pasur një numër të madh të palëve ndërgjyqese. Subjekti ka pasqyruar të gjithë palët ndërgjyqëse, paditësit, tri shtetas, të paditurit, katër shtetas, por njëkohësisht edhe një institucion publik ATP, si dhe 27 shtetas si persona të tretë në proces. Çështja konkrete, në referim të objektit, palëve ndërgjyqëse, provave të ndodhura në institucionet shtetërore (ATP, ZVRPP Tiranë) paraqet rrethana të veçanta, komplekse, që justifikojnë vonesë në shqyrtimin e saj. Në mbështetje të të drejtave të palëve në proces, gjykata ka disponuar me vendimmarrje në lidhje me praktikën mbi bazën e së cilës ka dalë vendimi nr. 4, datë 27.2.2001, ish-KKKP-së së ish-pronarëve (ATP), veprime këto të cilat kanë sjellë shtyrjen në kohë të shqyrtimi për shkak të kohës së kërkuar për njohjen me provat, rregullimin e ndërgjyqësisë si pasojë e regjistrimeve të bëra në ZVRPP-në Tiranë, komunikimi i ndryshimeve palëve në mungesë dhe në vijim komunikimet për disa palë ktheheshin të pakonfirmuara si pasojë e mosfunksionimit të rregullt të shërbimit të nëpunësve gjyqësorë për njoftimin e akteve.

Subjekti citon se Gjykata Kushtetuese ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm.

Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitohet çdo vonesë të panevojshme.

Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, dhe konkretisht në nenin 4 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme” dhe në nenin 171/a të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “Gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj”.

Subjekti ka cituar: “Në lidhje me dosjet e shqyrtuara nga Komisioni, unë, në rolin e gjyqtares, kam zbatuar detyrat procedurale dhe materiale, pa realizuar asnjë shkëlqje apo anashkalim që mund të prodhonte vonesë të procesit gjyqësor. Përveç kohëzgjatjes së proceseve në këto dosje nuk është identifikuar ndonjë veprim, mosveprim, sjellje, qëndrim, apo veprimtari konkrete që dëshmon vonesa të krijuara prej meje në kundërshtim me parimet dhe rregullat procedurale ligjore, kushtetuese dhe konventore apo të praktikës gjyqësore, të brendshme dhe ndërkombëtare, në këtë drejtim, për të cilat unë të jem ngarkuar me përgjegjësi disiplinore. Afati i gjykimit 5 vjet, 1 muaj e 20 ditësh (dosja 1), 2 vjet, 1 muaj e 8 ditësh (dosja 2) dhe 2 vjet, 2 muaj e 18 ditësh (dosja 4) ngjan si vonesë për shkak të mbingarkesës për gjykimin të mosmarrëveshjeve gjyqësore me të cilat jam përballur gjatë ushtrimit të detyrës së gjyqtares në Dhomën Civile, Seksioni Tregtar, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky afat gjykimi nuk është shkaktuar nga vonesa të papërgjegjshme të prodhuara prej meje, për shkak të mungesave, mosadministrimit të duhur procedural apo prej zvarritjeve të qëllimta të këtyre proceseve gjyqësore. Siç konkludon edhe Gjykata Kushtetuese⁶², ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij

⁶¹ Që i përket çështjes civile nr. *** regj., datë 4.7.2014, me paditës L.T., A. B. dhe F. T., kundër të paditurit AKKP-sëd, S. T., Z. T., A. T. e A. T., persona të tretë L. T., etj., me objekt “shfuqizimin e vendimit nr. 4, datë 27.2.2001 të KKP-së Tiranë...”, përfunduar me vendimin nr. *** , datë 26.9.2016, depozituar pas 1 muaji e 2 ditëve nga shpallja.

⁶² Vendimi nr. *** , 17.11.2015, i Gjykatës Kushtetues.

të fundit (i referohet organeve ekzekutive) të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë)⁶³, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht. Sa sipër, evidentohen dy momente, cenimi i të drejtës së individit për proces të rregullt ligjor dhe përgjegjësia e gjyqtarit. E para nuk sjell automatikisht të dytën. Në çdo rast, gjykimi tej afatit të arsyeshëm cenon procesin e rregullt ligjor, por jo detyrimisht kjo ndodh për shkak të papërgjegjshmërisë së gjyqtarit. Këtë frymë kanë edhe dispozitat që janë miratuar me ligjin nr. 38/2017 për gjykimin brenda afatit të arsyeshëm (nenet 399/1-399/12). Në kryerjen e detyrës kam përbulluar ngarkesën maksimale në punë, të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, duke mos lejuar kryerjen e asnjë veprimi apo mosveprimi që krijonte për fajin tim, me dashje apo nga pakujdesia, zvarritje të procesit gjyqësor”.

Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, konstaton se ky i fundit ka sqaruar në mënyrë të hollësishme elementët përbërës që duhen mbajtur në vëmendje përgjatë një procesi gjyqësor, duke iu referuar edhe jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese apo edhe të GJEDNJ-së, të cilët në mënyrë konstante ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit, si: (i) kompleksiteti i çështjes; (ii) numri i konsiderueshëm i palëve ndërgjyqëse; (iii) ushtrimi i të drejtave të tyre për të shtuar, pakësuar apo saktësuar objektin e padisë, siç edhe ka ndodhur; (iv) kërkimi për përfaqësime/mbrojtje ligjore, njohjet me kërkesat e njëpasnjëshme përfshirë edhe depozitime të kundërpasive, etj., veprime të cilat marrin kohën e tyre, përmbushin të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërgjyqëse për një proces të rregullt ligjor, lejojnë gjykatën të ndërmarrë veprime procedurale, vendimmarrje të ndërmjetme kur ligja e njeh dhe e kërkon, por që në përfundim ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit, problematikë e cila nuk mund t’i adresohet subjektit.

✓ Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe të dokumentacionit të depozituar, konkludon se subjekti ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me problematikat e konstatuara dhe, për pasojë, nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të saj.

Në vlerësimin e kriterit profesional, konsiderohet gjithashtu edhe konfirmimi i KLGJ⁶⁴-së se në regjistrin me të dhëna për procedimet disiplinore nuk rezulton ndonjë e dhënë që të jetë propozuar apo të jetë depozituar nga Ministri i Drejtësisë, pranë ish-KLD-së, ndonjë kërkesë për procedim disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016

Komisioni ka administruar 13 denoncime⁶⁵, ku njëri prej denoncuesve ka depozituar dy denoncime⁶⁶ me të njëjtin objekt ankimi. Në analizë të pretendimeve të parashtruara dhe dokumentacionit të depozituar, për katër prej tyre rezultuan problematika për të cilat i është kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe sipas problematikës së evidentuar të depozitujë edhe

⁶³ Dhe për analogji në të gjithë gjykatat e të gjithë niveleve në Republikës së Shqipërisë, të cilat përballen me mbingarkesë mosmarrëveshesh.

⁶⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2020, në përgjigje të Komisionit, me shkresën e nr. *** prot., datë 30.4.2020.

⁶⁵ Denoncim nr. *** prot., datë 26.12.2017, i shtetasit R. K.; denoncim nr. *** prot., datë 8.1.2018, i shtetasit F. D.; denoncim nr. *** prot., datë 10.1.2018, i shtetasit R. V.; denoncim nr. *** prot., datë 7.8.2018, i shoqërisë “S.”, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm G. K.; denoncim nr. *** prot., datë 10.9.2018, i shtetasit B. F.; denoncime nr. *** prot., datë 29.1.2019 dhe nr. *** prot., datë 26.7.2018, të shtetasit A. B.; denoncim nr. *** prot., datë 23.11.2018, i shtetasit S. Xh.; denoncim nr. *** prot., datë 27.12.2018, përcjellë nga KPA-ja, i shtetasit B. Sh.; denoncim nr. *** prot., datë 18.5.2018, i shtetasit A. C.; denoncim nr. *** prot., datë 28.6.2019, i shtetasit B. K.; denoncim nr. *** prot., datë 3.9.2019, i shtetasit F. M.; denoncime nr. *** prot., datë 10.10.2019, të shtetasit E. Ç..

⁶⁶ Denoncim nr. *** prot., datë 10.9.2018, i shtetasit B. F..

⁶⁶Denoncime nr. *** prot., datë 29.1.2019 dhe nr. *** prot., datë 26.7.2018, të shtetasit A. B..

dokumentacion në mbështetje të shpjegimeve. Ndërsa, për sa i përket denoncimeve të tjera Komisionit nuk i rezultuan problematika që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

1. Denoncimi⁶⁷ i shoqërisë “S.”, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm G. K.

1.1 Denoncuesi, i përfaqësuar edhe nga avokati, ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor civil (të identifikuar në cilësinë e palës së paditur) dhe ku subjekti ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Më konkretisht, ai qartëson se procesi gjyqësor me objekt “përmbushje të detyrimit kontraktor”, ka nisur prej korrikut të vitit 2015 dhe ka përfunduar në maj të vitit 2018. Gjithashtu, ka cituar se padia që prej depozitimit ka qenë me të meta për mospagim takse të saj dhe që disa herë është shtyrë për këtë qëllim. Po ashtu, pretendon se 7 seanca janë shtyrë për mosformim të trupit gjykues. Denoncuesi pretendon se vendimi është publikuar për më shumë se 1 muaj nga shpallja e tij, si dhe ka depozituar edhe ankimin e ushtruar në apel ndaj vendimmarrjes së shkallës së parë.

1.2 Komisioni i ka kërkuar subjektit që, megjithëse pretendimet e paraqitura lidhen kryesisht me veprimtarinë e punës së kryesueses së çështjes gjyqësore (pra, jo me subjektin e rivlerësimit), të japë shpjegime lidhur me ecurinë e procesit, kryesisht me qartësimin e shtyrjes së seancave për mosformim të trupit gjykues, si dhe të depozitojë çdo dokumentacion të vlerësuar në mbështetje të shpjegimeve.

1.3 Subjekti, në prapësimet e saj, ka sqaruar se çështja ka përfunduar gjykimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 4308, datë 14.5.2018 dhe aktualisht është në pritje të gjykimit mbi bazën e ankimit të paraqitur nga shoqëria “S.” sh.a.: *“Kam qenë në përbërje të trupit gjykues në cilësinë e anëtares së bashku me gjyqtaret R. M., kryesuese, R. P., anëtare. Në referim të ecurisë së procesit gjyqësor rezulton shtyrje e seancës gjyqësore në datën 9.5.2016, për shkak të mungesës sime si anëtare e trupit gjykues për arsye shëndetësore. Seanca e datës 11.7.2017, për shkak të zhvillimit nga ana ime të një procesi tjetër me masë sigurimi. Dy seancat rezultojnë të jenë shtyrë për arsye të justifikuar.”* Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 14.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe kronologjinë e seancave gjyqësore.

1.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, dokumentacionit të depozituar, vlerësuar në harmoni edhe me pretendimet e denoncuesit, ka konstatuar se qëndrojnë shpjegimet e subjektit në të dyja rastet e shtyrjes së seancave. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti, konkretisht kronologjia e zhvillimit të seancave gjyqësore, pasqyron arsyet objektive të shtyrjes së seancave në dy raste, për shkak se mosprezenca e subjektit ka ardhur për arsye shëndetësore dhe në rastin e dytë kur subjekti ka qenë caktuar me masat e sigurimit personal ku reflektohet se edhe pala paditëse është dakordësuar me shtyrjen e seancës. Pra, kohëzgjatja e zhvillimit të procesit gjyqësor në të dy rastet e mungesës së subjektit ka qenë tërësisht e motivuar dhe në tërësinë e periudhës trevjeçare të gjykimit ka një ndikim minimal në pretendimin e denoncuesit për zvarritje të procesit gjyqësor. Në kushte të tilla, nuk evidentohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

2. Denoncimi⁶⁸ i shtetasit B. F.

2.1 Denoncuesi, në ankimin e tij në cilësinë e kandidatit për kreun e FSHF-së (në zgjedhjet e datës 7.2.2018), pretendon për shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në vendimin nr. ***, datë 10.7.2018, ku është vendosur: *Pranimi i kërkesës; depozitimi në regjistrin e OJF-ve i disa vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme të FSHF-së.* Denoncuesi e ka quajtur vendimin haptazi të dhënë në kundërshtim me ligjin dhe njëkohësisht pretendon se në të vërehen edhe elementë të shpërdorimit të detyrës. Ndër të tjera, ka sqaruar se fillimisht çështja është

⁶⁷ Denoncim nr. *** prot., datë 7.8.2018, i shoqërisë “S.”, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm G. K..

⁶⁸ Denoncimi nr. *** prot., datë 10.9.2018, i shtetasit B. F..

shqyrtuar nga një tjetër gjyqtare, e cila kishte vendosur kthimin palës kërkuese me disa detyra për t'u përmbushur, për shkak se nga kjo e fundit nuk ishin plotësuar të gjitha të metat. Denoncuesi qartëson se ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim nga pala kërkuese (FSHF). Më tej parashtron se çështja ka rinisur gjykimin nga subjekti për arsye se mbi kërkimin e FSHF-së për përjashtimin e gjyqtares së parë gjykata kishte vendosur pranimin e kërkesës. Denoncuesi, në shkeljet e adresuara ndaj subjektit në vendimmarrjen e saj, e vë theksin tek moskërkimi i përmbushjes së detyrave të lëna (të FSHF-së) nga gjykata prej kthimit në kërkimin e parë, për plotësim të metave, për faktin se vendimi kishte qenë i formës së prerë. Ai pretendon se subjekti duhet të kishte kthyer kërkesën që me marrjen e saj për gjykim, pra, që në momentin e depozitimit të kërkesës në mënyrë të përsëritur, për arsye se pala duhet të kishte depozituar të gjitha aktet e lëna si detyrë nga vendimmarrja e parë. Denoncuesi ankohet gjithashtu se subjekti ka dhënë vendimin në tejkalim të afatit 15-ditor, nga momenti i marrjes në dorëzim të praktikës. Gjithashtu, denoncuesi ka adresuar disa pyetje në ankimin e tij, duke i fokusuar si pjesë përbërëse të shkeljeve të kryera në vendimmarrje. Denoncuesi nuk ka bashkëngjitur dokumentacion.

2.2 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në mënyrë të detajuar prej pikënisjes së procesit dhe deri në finalizimin e tij me vendimmarrje: (i) të depozitohet vendimin e kthimit të kërkesës (nga nisja e procesit për herë të parë me një tjetër gjyqtare) për plotësim të metash, si dhe çdo dokumentacionin tjetër mbështetës të shpjegimeve të saj (si kërkesën e palës mbi të cilën ka gjykuar, vendime të ndërmjetme nëse ka pasur, vendimmarrjen finale dhënë prej saj, etj.); (ii) të qartësojë mbi statusin aktual të çështjes; si dhe (iii) të qartësojë nëse është adresuar kallëzim nën akuzën “për shpërdorim detyrë” ndaj saj, për çështjen objekt gjykimi dhe nëse po, të sqarohet mbi statusin aktual të tij.

2.3 Subjekti, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Në datën 30.5.2018 më është caktuar për shqyrtim nëpërmjet procedurave të shortit kërkesa me kërkuës: Federata Shqiptare e Futbollit, me objekt ‘depozitimi në regjistrin e organizatave jofitimprurëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të Vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së, të datës 7.2.2018. Me vendimin nr. ***, datë 28.3.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare M. O., ka vendosur: kthimin e akteve palës kërkuese FSHF-së. Pas kthimit të akteve çështja është paraqitur sërish dhe i është caktuar për gjykim me short gjyqtares M. O. në datën 3.5.2018. Me vendim nr. *** akti, datë 9.5.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare M. B., ka vendosur: kërkesën e FSHF-së për përjashtimin e gjyqtares M. O.. Çështja është hedhur përsëri në short dhe i është caktuar për gjykim gjyqtarit J. H. (datë 21.5.2018), i cili ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi, me kërkesë datë 29.5.2018, për shkak se është anëtar i Komisionit të Apelit të FSHF-së. Kryetari i gjykatës, me vendimin ‘Për kërkesën për zëvendësim gjyqtari’, datë 29.5.2018, ka pranuar kërkesën për heqje dorë të gjyqtarit J. H.. Në datën 30.5.2018 më është caktuar për shqyrtim, nëpërmjet procedurave të shortit, kërkesa me kërkuës FSHF-në. Me vendimin nr. ***, datë 10.7.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me gjyqtare M. Sh., ka vendosur: pranimin e kërkesës. Depozitimin në regjistrin e organizatave jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të disa vendimeve⁶⁹, të cilat janë renditur në mënyrë kronologjike. Në përgjigje të kërkesës drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë më është kthyer përgjigje me shkresën nr. *** prot., datë 9.2.2021, se: nuk rezulton në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë të jetë regjistruar ndonjë kallëzim penal nga shtetasi B. F. në adresën tuaj në lidhje me vendimin nr. ***, datë 10.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 9.2.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe praktikën e plotë për të gjithë vendimmarrjen në lidhje me vendimin nr. ***, datë 10.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

⁶⁹ Nr. 1-11, datë 7.2.2018, i Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme të Federatës Shqiptare të Futbollit të datës 7.2.2018.

2.4 Trupi gjykues, nisur nga pretendimet e denoncuesit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacioni i depozituar nga ky i fundit, ka konstatuar se FSHF-ja, me cilësinë e kërkuarit, i është drejtuar me kërkesë, me datë regjistrimi 1.3.2018, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Depozitimin e disa vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së”. Mbi këtë kërkesë, gjykata, me vendimin nr. ***, datë 28.3.2018, pasi ka ezauruar edhe qëllimin e vendimit të ndërmjetëm datë 12.3.2018, për të pritur plotësimin e akteve nga kërkuari, brenda një afati të arsyeshëm, ka vendosur: kthimin e kërkesës palës kërkuar. Në vijim, në datën 3.5.2018 kërkuari i është drejtuar përsëri gjykatës, me objekt “Depozitimin në regjistrin e organizatave jofitimprurëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të Vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së, të datës 7.2.2018”. Çështja i është nënshtruar disa kërkesave të gjyqtarëve për dorëheqje, pas të cilave, në datën 30.5.2018 i është caktuar subjektit të rivlerësimit. Kjo e fundit, me vendimin nr. ***, datë 10.7.2018, ka pranuar kërkesën e FSHF-së me objektin e përcaktuar në të. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se subjekti duhej të kishte kthyer kërkesën për përmbushjen e të metave të konstatuara nga vendimi i mëparshëm datë 28.3.2018, pasi ky i fundit kishte marrë formë të prerë, parimisht nuk mund të vlerësohet si një domosdoshmëri, për sa kohë kërkimi i radhës ka ardhur pas më shumë se një muaji nga vendimmarrja e parë, ndërsa është kompetencë e gjykatës të njihet, studiojë praktikën dhe të vlerësojë lidhur me plotësimin e akteve sipas procedurës së kërkuar nga ligji, pra, thënë ndryshe, çështja nuk mund të paragjykohe apo hamendësohet nëse ishin përmbushur të metat e konstatuara më parë apo jo. Ky konkludim bëhet evident edhe për faktin se denoncuesi nuk ka qenë pjesë e procesit gjyqësor dhe në kushte të tilla çdo krahasim mes dy vendimmarrjeve do të dukej e vlerësuar apriori nga trupi gjykues, apo duke i vënë theksin themelit të çështjes, veprim i cili del përtej kompetencave të Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit profesional. Për sa i përket pretendimit tjetër të denoncuesit se subjekti ka dhënë vendimin në tejkalim të afatit 15-ditor nga momenti i marrjes në dorëzim të praktikës, konstatohet se çështja, pavarësisht se është regjistruar në datën 2.5.2018, prej kohës kur i është caktuar subjektit, datë 30.5.2018, dhe deri në përfundimin e saj me vendimin nr. ***, datë 10.7.2018, është shqyrtuar për një periudhë rreth 40-ditore, pra, tej afatit 15-ditor të parashikuar në nenin 24 të ligjit nr. 8789, datë 7.5.2001, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”. Por, nga aktet e administruara në dosjen objekt gjykimi vërehet se rol në këtë periudhë shqyrtimi ka pasur edhe zhvillimi i disa seancave ku reciprokisht nga gjykata është kërkuar depozitimi i disa akteve dhe nga kërkuari është kërkuar koha e nevojshme për sjelljen e tyre, veprim ky që lidhet edhe me ushtrimin e të drejtave të palëve ndërgjyqëse për një proces të rregullt ligjor. Në praktikën gjyqësore në këtë rast nuk rezulton të jetë administruar ndonjë kërkesë për zvarritje gjykimi. Nga aktet e depozituara nga subjekti në prapësime, vërehet gjithashtu se mbi kërkesën e subjektit edhe organi i prokurorisë ka informuar se nga verifikimet e kryera nuk ka rezultuar që në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë të jetë regjistruar ndonjë kallëzim penal nga denoncuesi në adresë të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vendimin nr. ***, datë 10.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- ✓ Në kushte të tilla, trupi gjykues, pa zëvendësuar logjikën e gjyqtarit në vendimmarrje, në tërësi të analizës sa më sipër cituar, nuk konstaton problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

3. Denoncimi⁷⁰ i shtetasit F. M.

3.1 Denoncuesi (me cilësinë e përfaqësuesit të trashëgimtarëve të të ndjerës I. G.) ankohet për vendim të padrejtë dhënë nga subjekti i rivlerësimit. Ai pretendon se në vendimin e dhënë nuk janë zbatuar detyrat e lëna nga apeli dhe Gjykata e Lartë për të pasur një hetim të thelluar në lidhje me çështjen e pronësisë të pretenduar dhe, më konkretisht, lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv të një kontrate huaje, e cila sipas denoncuesit nuk i ishte nënshtruar gjykimit dhe se përbënte thelbin

⁷⁰ Denoncimi nr. *** prot., datë 3.9.2019, i shtetasit F. M..

e procesit. Përkundrazi, shprehet denoncuesi, subjekti e ka trajtuar këtë moment si gjë të gjykuar. Denoncuesi ka cituar vendimet gjyqësore, por nuk i ka depozituar ato.

3.2 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime, duke u përqendruar në pretendimet e denoncuesit, të depozitojë vendimet gjyqësore që qartësojnë situatën deri në statusin aktual të kësaj çështjeje gjyqësore, si dhe çdo dokumentacion të vlerësuar në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

3.3 Subjekti, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka qartësuar lidhur me vendimmarrjen. Ajo ka pasqyruar palët ndërgjyqëse dhe objektin e padisë, si dhe faktin se me vendimin nr. ***, datë 15.7.2019, është vendosur rrëzimi i padisë i paditësve S. D., L. M., etj., me të paditur Zyrën e Përmbarrimit Tiranë, etj., me objekt “kundërshtim i veprimeve përmbarrimore”, etj. Subjekti është shprehur se në bazë të ankimit të paraqitur nga pala paditëse ndaj vendimit nr. ***, datë 15.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja është në pritje të gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në përmbajtje të vendimit gjejnë pasqyrimin respektimi i detyrave të lëna nga gjykatat më të larta, si dhe analizimi i instituteve të së drejtës që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Subjekti ka depozituar vendimet gjyqësore në lidhje me mosmarrëveshjen. Lidhur me statusin aktual të çështjes objekt gjykimi subjekti ka deklaruar se në bazë të ankimit të paraqitur nga pala paditëse, ndaj vendimit nr. ***, datë 15.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja është në pritje të gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë.

3.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, dokumentacionit të depozituar, vlerësuar në harmoni edhe me pretendimet e denoncuesit, ka konstatuar se çështja objekt gjykimi e ka zanafillën prej vitit 2010, kur dhe është kërkuar nga njëra prej palëve ndërgjyqëse (e cila ka vënë në lëvizje gjykatën), lëshimi i Urdhrit të Ekzekutimit të një kontrate huaje dhe që më pas është vendosur pranimi i kërkesës me vendimin me nr. *** akti, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga vendimet gjyqësore të depozituara nga subjekti vërehet se më pas kemi të bëjmë me gjykimin e një çështjeje të përzier, me disa palë ndërgjyqëse, të cilat pretendojnë se janë cenuar nga ekzekutimi i kontratës së huas, akt që ka pasur në objekt kthimin e një shume relativisht të lartë, me disa objekte padie, duke nisur me pavlefshmëri të titullit ekzekutiv, kundërshtim të veprimeve përmbarrimore, kthimin e pasurisë apartament, etj. Duke qëndruar tek pretendimi i denoncuesit konstatohet se subjekti është shprehur me vendimin nr. ***⁷¹, datë 15.7.2019, për objektin e padisë “Kundërshtim i veprimeve përmbarrimore, pavlefshmëri absolute e veprimtari juridik”, etj. Ajo që vihet re është fakti se, kjo vendimmarrje i referohet vendimit nr. ***, datë 22.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit është vendosur rrëzimi i padisë së ngritur nga e ndjera I. G., si dhe detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***⁷², datë 4.2.2015, sipas të cilit është prishur vendimi i shkallës së parë dhe çështja është kthyer për rigjykim. Në të tilla kushte, arsytimi i rigjykimit të çështjes është detyrë e subjektit të rivlerësimit, bazuar në prova, ligj dhe detyrat e lëna, për të cilat ky trup gjykues nuk mund të zëvendësojë logjikën e subjektit të rivlerësimit, përveçse është e drejta e palës ndërgjyqëse që të ushtrojë ankimin përkatës në gjykatat e shkallëve të tjera, të cilën në fakt e ka ushtuar. Për rrjedhojë, trupi gjykues, në analizë për sa më sipër, nuk konstaton problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit.

4. Denoncime⁷³ të shtetasit E. Ç.

4.1 Denoncuesi ankohet për shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, duke informuar se ka zhvilluar seancat, në disa raste, pa audio dhe se ka refuzuar të marrë prova. Ai pretendon se gjyqtarja ka qenë e njëanshme në proces, ka refuzuar masën e kërkuar për sigurim

⁷¹ Që i përket rigjykimit të çështjes, sipas vendimit nr. ***, datë 4.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

⁷² Ky vendim është rekursuar dhe në përfundim Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 13.4.2018, ka vendosur: mospranimin e rekursit nga pala e paditur E. Gj..

⁷³ Denoncimi nr. *** prot., datë 10.10.2019, i shtetasit E. Ç..

padie, si dhe ka zvarritur procesin pa arsye. Denoncuesi sqaron se ka depozituar edhe kallëzim penal ndaj subjektit, nën akuzat “falsifikim i dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre”, të cilin e ka bashkëngjitur me dokumentacionin në tërësi. Ai ka depozituar edhe një CD bashkëngjitur denoncimit. Nga aktet e depozituara nuk qartësohet nëse procesi vijon apo ka përfunduar.

4.2 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime (nëse çështja ka përfunduar së gjykuari), duke u përqendruar tek pretendimet e denoncuesit, të depozitohet çdo dokumentacion të vlerësuar, si dhe të qartësojë mbi statusin aktual të kallëzimit penal të bërë ndaj saj.

4.3 Subjekti, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... kam pasur për gjykim çështjen civile me nr. *** akti, datë 2. 2.2018, që iu përket paditës/denoncuesi, të paditur – disa shoqëri, me objekt ‘detyrim për përmbushje detyrimi’, ‘shpërblim dëmi dhe marrje mase sigurie’. Janë kryer veprimet paraprake për çështjen, janë kryer seancat përgatitore, është vendosur në lidhje me kërkesat e paraqitura nga pala paditëse për sigurimin e objektit të padisë për këqyrjen e objektit, etj. Në vijim është paraqitur nga pala e paditur kundërpadi, e cila është pranuar për shqyrtim nga gjykata, në mbështetje të nenit 160 të Kodit të Procedurës Civile. Në datën 1.10.2019 është paraqitur prej meje ‘kërkesë për heqje dorë’, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kishte regjistruar kallëzimin nr. *** ndaj meje si gjyqtare. Kërkesa për heqje dorë është miratuar nga kryetari i gjykatës me vendimin datë 4.10.2019. Çështja është hedhur në short dhe është duke u gjykuar nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me vendimin datë 21.10.2019, ka vendosur: mosfillimin e procedimit penal për materialin e kallëzuar nga shtetasi E. C. kundër shtetases Mariana Shegani, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 4.3.2020, ka vendosur: të rrezojë si të pabazuar në ligj dhe në prova ankimin kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal të datës 4.10.2019, që i përket kallëzimit penal nr. ***, viti 2019. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.***, datë 9.9.2020, ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 4.3.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ndaj vendimit nr. ***, datë 9.9.2020, ka paraqitur rekurs ankuesi E. C.” Subjekti ka depozituar së bashku me prapësimet aktet provuese⁷⁴ në mbështetje të shpjegimeve.

4.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar, ka konstatuar se për çështjen objekt gjykimi janë zhvilluar disa seanca përgatitore dhe gjyqësore dhe se në të gjitha rastet janë pasqyruar arsyet e shtyrjeve. Gjithashtu konstatohet se në proces, palët kanë qenë në cilësinë e paditësve të kundërpaditur dhe se janë dhënë disa vendime mbi veprimet paraprake, si lidhur me saktësimin e bërë në kërkesëpadi dhe njoftimin e saj, komunikimi i deklaratës së mbrojtjes, komunikimi i kundërshtive të paditësit për deklaratën e mbrojtjes, etj. Gjykata, me vendimin datë 24.9.2018, është shprehur edhe lidhur me sigurimin e padisë. Në tërësi duket të ketë qenë një çështje e tejzgatur në gjykim, por që parë nga kompleksiteti i saj nevoja e kryerjes së akteve të ekspertimit, kontestimet lidhur me caktimin e ekspertit apo mbi aktekspertimet, kërkesat e palëve për shtyrje seancash, kërkesa e denoncuesit për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i çështjes, etj., nënkuptojnë kohën e nevojshme që mund t’i jepet palëve në proces si një e drejtë legjitime për një proces të rregullt ligjor. Trupi gjykues nuk mund të konkludojë lidhur me themelin e çështjes apo të zëvendësojë logjikën e gjyqtarit në vendimmarrjet përkatëse, për sa kohë këtë atribut e ushtrojnë gjykatat e shkallëve më të larta mbi ankimin e palëve, përfshirë edhe vendimmarrjen e sigurimit të padisë dhënë nga subjekti. Por, në këtë rast gjykimi i çështjes nuk zhvillohet më nga subjekti, pasi kërkesa e saj për dorëheqje (nisur

⁷⁴ Vendim datë 21.10.2019, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për “mosfillimin e procedimit penal”; vendim nr. ***, datë 4.3.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vendim nr. ***, datë 9.9.2020, i Gjykatës së Apelit Durrës; ankimet e z. E. Ç. ndaj vendimeve dhe rekursit në Gjykatën e Lartë.

nga kallëzimi penal i bërë nga denoncuesi) është miratuar nga drejtuesi i institucionit në datën 4.10.2019.

VLERËSIM TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës, nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriteret e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në provat e administruara, në shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi), për sa i takon kriterit të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, çmon se:

Për pasurinë apartament me sip. 113 m², në rr. “M. Sh.”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, si dhe rezulton të jetë në pamundësi financiare në shumën 1.677.838 lekë, për të paguar dy këstet e para të kësaj pasurie.

Për pasurinë apartament me sip. 45.5 m², në K., Kavajë, subjekti ndodhet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi rezultoi në mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 1.354.372 lekë, për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera ndër vite.

Për pasurinë automjet tip “**”**, subjekti ndodhet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 , pasi rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 966.243 lekë.

Trupi gjykues konkludon në tërësi se subjekti gjendet në balancë negative në shumën 3.998.453 lekë, për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, ndër vite, duke e kualifikuar për këtë kriter se ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe se nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas parashikimit të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi), ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në pikën 2 të nenit 4, germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi), gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 23.2.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta